- **REFERAT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN KËSHILLTAR SHKENCOR NË DEPARTAMENTIN LIDHJEVE TË NDËRSJELLA KULTURORE, HISTORIKE DHE GJUHËSORE MIDIS SHQIPTARËVE DHE MAQEDONASVE DHE POPUJVE TJERË TË RAJONIT NË ITSHKSH – SHKUP (Dr. Sefer Tahiri) fq. 81 – 93**

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN KËSHILLTAR SHKENCOR NË DEPARTAMENTIN E HISTORISË SË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË SË VERIUT DHE LËVIZJEVE DEMOGRAFIKE NË ITSHKSH – SHKUP

Në bazë të konkursit publik të shpallur më 15.03.2021, në gazetata ditore “Lajm” dhe “Нова Македонија” për zgjedhjen e dy këshilltarëve shkencorë në Departamentin Historia e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjet demografike në IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh) në Shkup, Këshilli i Institutit në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 29.3.2021, me vendimin nr. 0201-195/2, ka zgjedhur për anëtarë të Komisionit recensues, në përbërje: kryetar prof. dr. Naim Alimi - këshilltar shkencor (ITShKSh - Shkup), dhe anëtarët prof. dr. Zeqirja Idrizi – profesor ordinar (Universiteti “Fadil Sulejmani” - Tetovë) dhe prof. dr. Qemal Murati - këshilltar shkencor (ITShKSh - Shkup). Si anëtarë të Komisionit recensues, kemi nderin që Këshillit të IPSh Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, t’i dorëzojmë këtë raport.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues konstaton se në konkursin publik për zgjedhje/rizgjedhje në thirrjen shkencore këshilltarë shkencorë në Departamentin e Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjet demografike në IPSh Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, janë paraqitur dy kandidatë: dr. Skender Asani - bashkëpunëtor i lartë shkencor, dhe dr. Sevdail Demiri – bashkëpunëtor i lartë shkencor. Ky raport i referohet kandidatit:

Dr. Skender Asani, bashkëpunëtor i lartë shkencor.

1. Të dhënat biografike dhe arsimimi:

Skender (Sadik) Asani u lind më 7 prill të vitit 1972 në Shkup, ku mbaroi shkollën fillore dhe atë të mesme. Në vitin 1994 u regjistrua mes studentëve të parë në gjeneratën e parë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës – drejtimi: Histori. Me këmbëngulje dhe përkushtim të madh në vitin 1998 diplomoi ndër studentët e parë në universitetin e lartpërmendur. Tema e punimit të diplomës titullohej: “Kryengritja e Dervish Carës”, me mentor prof.dr. Ramiz Abdyli. Po në të njëjtin vit, Asani u regjistrua në studimet post-diplomike në Universitetin e Tetovës. Tezën e magjistraturës me temë “Kryengritja gjithëshqiptare prej vitit 1912 sipas burimeve bullgare”, me mentor prof.dr.Ramiz Abdyli, e mbrojti me sukses në vitin 2003 duke fituar kështu titullin magjistër i shkencave të historisë. Në vitin 2010, në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, regjistroi doktoraturën, të cilën e mbrojti në vitin 2013 me temën: “Aktiviteti i

organizatës politike Xhemijeti në pjesën e Maqedonisë së Vardarit (1919-1925)”, me mentor prof. dr. Nadezhda Cvetkovska.

Skender Asani, paralelisht me përgatitjen e disertacionit të doktoraturës, në mënyrë aktive ka hulumtuar në fushën e historisë. Prej vitit 2010 edhe aktualisht është kryetar i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, ndërsa prej vitit 2008 është i punësuar në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Prej vitit 2014 është edhe drejtor i Institutit, ndërsa mandatin e dytë si drejtor të Institutit e ka marrë nga viti 2018 dhe ende ushtron këtë detyrë.

Prof. dr. Skender Asani, ka marrë pjesë në të gjitha projektet dhe konferencat shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, si dhe në institucionet tjera shkencore, shoqata dhe organizata të ndryshme të cilat kanë organizuar sesione shkencore, konferenca, seminare brenda dhe jashtë shtetit. Ka publikuar edhe një numër të madh artikujsh nëpër revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe pesë libra shkencor (te njëri prej tyre është bashkëautor) të cilat kanë rëndësi të veçantë në fushën e shkencës së historisë së shqiptarëve në Maqedoni.

Prof.Dr. Skender Asani për nevojat e punës së tij, ka kryer hulumtime të rëndësishme në veçanti në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë në Shkup, Arkivin e Qytetit të Shkupit, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup, në Arkivin Historik të Shqipërisë në Tiranë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë, në Arkivin e Kosovës në Prishtinë, Arkivin Shtetëror të Serbisë në Beograd, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë në Romë, etj.

2. Veprimtaria hulumtuese - shkencore:

Prof. dr. Skender Asani, në aspektin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, dallohet sidomos me publikimet dhe veprat e tij shkencore në fushën e historisë së shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Në këtë periudhë ka publikuar disa libra të rëndësishme shkencore historike dhe përmbledhje me dokumente, kryesisht me interes për historinë e Shkupit dhe shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut në përgjithësi. Në këto botime bëjnë pjesë veprat: “Rrugëtimi - Патешествие - Journey”, ITShKSh & Acta Non Verba, Shkup, 2017”, në të cilën Asani ka rolin e bashkautorit me Albert Ramaj; “Dokumente, fotografi dhe dëshmi për familjet katolike shqiptare në Shkup (Monografi I)” në bashkautorësi me Albert Ramaj dhe Natasha Didenko, Acta Non Verba, Shkup, 2017; “Dega e Shkupit e Lidhjes së Prizrenit dhe Jashar Bej Shkupi, (Përmbledhje me Dokumente)”, ITShKSh, Shkup, 2018”; “Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar (1941-1944), në dritën e dokumenteve shqiptare” përmbledhje me dokumente në bashkautorësi me Sevdail Demirin, ITShKSh, Shkup, 2018”; “Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë” - me grup autorësh, ITShKSh, Shkup, 2018”; “Shkupi për Vitin e Skënderbeut (1468-2018) / Скопје за годишнината на Скендербег (1468-2018) / Skopje for Skenderbeg Year (1468-2018), ITShKSh, Shkup, 2018”, “Familjet Katolike Shqiptare në Shkup (dokumente, fotografi dhe dëshmi - II) / “Catholic Albanian Families in Skopje (documents, pictures and testimonies - I)”, në bashkautorësi me

Albert Ramaj dhe Nora Maliqi, ITShKSh - Acta Non Verba, Shkup, 2018”; “Kontesti kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së SKS-së (1919 – 1925), (dokumente), në bashkautorësi me Isamedin Azizi, ITShKSh, Shkup, 2019”; “Legjislacioni bazik antisemitik në mbretërinë e Bullgarisë, përmbledhje dokumentesh”, në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali dhe Vllado Popovski, ITShKSh, Shkup, 2020, i cili u botua veçmas edhe në gjuhën maqedonase dhe atë angleze; “Nga Gonxhe Bojaxhiu deri te Nënë Tereza - Një sage për jetën e shqiptarëve katolikë të Shkupit –“ / “From Gonxhe Bojaxhiu to Mother Theresa - A saga about the life of Albanian Catholics from Skopje“, në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali dhe Albert Ramaj, ITShKSh, Shkup, 2020; “Konti Bertold dhe çështja shqiptare”, në bashkautorësi me Qerim Lita, ITShKSh, Shkup, 2020; “Ditari i Parashqevi Qiriazit - Ditët e mija në Konferencën e Versajës, dokumente”, në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali, ITShKSh, Shkup, 2020”; dhe “Adresat e reja të një kujtese”, ITShKSh, Shkup 2021.

Në këto libra historike-shkencore, të cilat bazohen në dokumente origjinale të hulumtuara në arkivat në Shkup, Tiranë, Beograd dhe Romë, ndriçohen shumë rrethana historike të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në Shkup. Me to autori ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në sqarimin e shumë dilemave shkencore që lidhen me historinë e shqiptarëve të këtushëm. Me këto botime plotësohet një boshllëk i madh i informacioneve që kishte deri më tani historiografia shqiptare për këto troje.

Dr. Skender Asani ka publikuar edhe punime shkencore-profesionale në fushën e historisë, disa prej të cilave nëpër periodikët shkencorë ndërkombëtarë, nga të cilët po veçojmë punimin: “E kaluara ngulfat të ardhmen e Maqedonisë”, botuar në “Balkan Perspectives”, nr. 06 – 2016, Shkup. Ndërsa, ka publikuar dhjetëra punime nëpër revista profesionale-shkencore në Shkup, Tiranë e Prishtinë, si: “Shtypi shqiptar në Maqedoni për kërkesën ‘Kosova Republikë’, në vitet 1981-1982”, në bashkautorësi me S. Demiri, Lëvizja, nr.2, Prishtinë, 2018; “Veprimtaria e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1985-1987”, në bashkautorësi me Halide Palloshi, “Lëvizja”, nr.3, Prizren, 2020; “Gjendja e (mos) arsimimit në territoret verilindore shqiptare” (në bashkautorësi me S. Demiri), Scupi – 17, ITShKSh, Shkup, 2017; “Skënderbeu i ri (një interpretim ndryshe), “Studime Albanologjike” - 17, ITShKSh, Shkup, 2018; “Burimet e hulumtuara për veprimtarinë politike të Xhemijetit” në “Kërkime historike” – 9/10, Shkup, 2017; “Familjet katolike shqiptare të Shkupit, në fokusin e historisë”, në bashkëautorësi me S.Demiri, “Studime Muzeologjike”, nr. 8., Tiranë, 2018; “Vulën e kombndertimit të shqiptarëve e bëri Kongresi i Manastrit”, Scupi – 23, ITShKSh, Shkup, 2018; “Proceset pozitive zor se do të mund të ndodhin, pa intervenimin energjik të NATO-s 20 vjet më parë”, Scupi – 25, ITShKSh, Shkup, 2019; “Evropa një sallë operacioni ku vetem kirurgët amerikan kryejn punën”, ‘Ditët e Alfabetit’ - I, ITShKSh, Shkup 2020, etj.

Ai mori pjesë në shumë tubime profesionale-shkencore me referate dhe kumtesa, si në: Simpoziumin shkencor të organizuar më 19.01.2019 në Prizren nga Shoqëria “Lëvizja”, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Instituti Albanologjik – Prishtinë dhe ITShKSh -Shkup, me temë “Lëvizja e viteve 1985-1987 dhe mbledhja e saj e parë e

përgjithshme”; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, 06.03.2018, Prishtinë; simpoziumin shkencor të organizuar nga Shoqëria “Lëvizja”, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Instituti Albanologjik – Prishtinë dhe ITShKSh - Shkup, me temë “Lëvizja Popullore e Kosovës në vitet 1982 – 1984 dhe heronjtë Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Bajram Bahtjari e Zija Shemsiu”, 25.01.2018, ITShKSh, Shkup; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, 10.06 2018, Prizren; Konferencën shkencore “Veprimtaria atdhetare e Shotë Galicës”, 21.12. 2017, Prishtinë; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 550 vjetorin e vdekjes”, 16.10.2018, Prishtinë; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Antifashizmi popullor tek shqiptarët në kuadër të 75 vjetorit të çlirimit”, 31.07. 2019, Tiranë; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe koha e tij”, 02.05 2018, Tiranë; Konferencën shkencore ndërkombëtare “Fytyra e armikut të popullit gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri 1944-1990”, 19.05 2019, Tiranë; etj.

Gjatë kësaj periudhe, Skender Asani ka qenë udhëheqës i disa projekteve hulumtuese shkencore, me mjaft interes, nga të cilët po veçojmë: “Xhamitë dhe Teqetë në Shkup dhe rrethinë, në periudhën në mes dy Luftrave Botërore”, ITShKSh - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019; “100 Years Wilson, Paris Peace Conference Albanian American Friendship”, ITShKSh, Komuna e Çairit, IAPS - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019; “The Path of the Righteous – Holocaust Stories of Macedonia and Albania. Through the life of the survivors and Righteous”, ITShKSh - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019; “Животот на Старата Скопска Чаршија низ вековите”, Acta Non Verba- projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019; “Zhvillimet kulturore – historike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut gjatë shek. XIX-XX” – projekt hulumtues trevjeçar i ITShKSh-së - Shkup (2021-vijim), etj.

Për realizimin e punës hulumtuese – shkencore, ka bërë hulumtime nëpër disa qendra arkivore, si në Arkivin e Punëve të Jashtme të Italisë në Romë, 2019; Arkivin Shtetëror të Serbisë në Beograd, 2019; Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë – Tiranë, 2019; etj.

Ka qenë anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të magistraturës së kandidatëve Driton Osmani, Arbër Shaqiri, Lulzim Kashtanjeva, në ITShKSh – Shkup, si dhe anëtar i komisionit të mbrojtjes së disertacionit të doktoraturës “Pozita e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918 – 1941” të kandidatit Besnik Rameti në Universitetin e Tetovës, 2020.

3. Veprimtaria profesionale-aplikative dhe veprimtari me interes më të gjerë:

Kandidati dr. Skender Asani, ka edhe një spektër mjaft të gjerë aktivitetesh në planin profesional-aplikativ dhe veprimtarive me interes më të gjerë. Me rizgjedhjen e tij si drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve -

Shkup (prej vitit 2018), ka treguar interes të madh edhe për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Institutit, përmes organizimeve të shumta shkencore dhe kulturore në Shkup, Manastir, Prishtinë, Prizren, Tiranë, Nju Jork, Uashington, etj.

Asani është anëtar i këshillit redaktues të dy numrave të parë të revistës shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia”, botim i ITShKSh -së në vitin 2019 dhe 2020. Është anëtar i redaksisë së revistës profesionale-shkencore “Scupi”, poashtu botim i Institutit, me numër 17, 18, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 30, të revistës “Kërkime Historike”, numër 9 dhe 10. Poashtu, merr pjesë aktive edhe në këshillin redaktues të botimit të veçantë të ITShKSh -së, me titull “Ditët e Alfabetit”, ku janë botuar materiale të larmishme nga përmbajtja e manifestimit kulturor dhe shkencor me të njëjtin emër, të mbajtur në Shkup dhe Manastir.

Ka qenë kryetar i Këshillit Organizues të shumicës së tubimeve shkencore të Institutit, nga të cilat veçojmë tubimet shkencore për nderë të nobelistes shqiptare Nënë Tereza, tubimet që lidhesin me Holokaustin, si dhe konferencat shkencore në shenjë përkujtimi të Kongresit të Manastirit, që u mbajtën në Shkup dhe Manastir, me pjesëmarrjen e dhjetëra studiuesve të njohur nga Tirana, Prishtina dhe viset tjera shqiptare. Ishte anëtar i Këshillave Organizuese të disa konferencave shkencore në Prishtinë dhe Tiranë, si: konferenca shkencore ndërkombëtare “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, 06.03.2018, Prishtinë; në simpoziumet shkencore të bashkorganizuara nga Shoqëria “Lëvizja” në Prizren, Shkup e Tiranë; konferencën ndërkombëtare “Komiteti mbrojtja kombëtare e Kosovës dhe koha e tij”, 02.05 2018, Tiranë, nën organizimin e Institutit të Historisë në Tiranë, etj.

Në këtë plan, dr. Skender Asani është bartës i disa projekteve të Shoqatës së Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, të mbështetura nga ana e Qytetit të Shkupit dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën 2017-2020, dr. Skender Asani është anëtar i disa komisioneve profesionale në Ministrinë e Kulturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, anëtar i disa komisioneve të Qytetit të Shkupit për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve të qytetit, si dhe anëtar i bordit të komisioneve të Postave të Maqedonisë së Veriut për emetim të pullave postare. Gjatë angazhimit të tij serioz nëpër këto komisione, ka bërë që të marrin çmimet e merituar personalitete të shquara të kulturës dhe shkencës shqiptare. Ndërsa si anëtar i bordit të Postave të Maqedonisë së Veriut për emetim të pullave postare, ka bërë që personalitete të shquara shqiptare të jenë pjesë e imazheve postare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, dr. Skender Asani është edhe në rolin e recensentit të disa veprave shkencore, nga të cilat po veçojmë: “Manastiri - vatër e Rilindjes Kombëtare Shqiptare (shek. XIX deri në vitin 1912)” autor Nebi Dervishi, ITShKSh, Shkup, 2018; “Shkrime Historike” - Halim Purellku, ITShKSh, Shkup, 2018; “Skënderbeu në vendet nordike” – Xhevat Lloshi & John Quanrud, ITShKSh, Shkup, 2018; “Shkrime historike” nga Ali Vishko, ITShKSh, Shkup, 2020; “Vepra e Anton Çettës përlligj qenësinë e trashëgimisë sonë” - Anton Nikë Berisha, ITShKSh, Shkup, 2020, etj.

Gjatë kësaj periudhe, Skender Asani, në cilësinë e drejtorit të Institutit, një angazhim admirues ka pasur në promovimin e këtij institucioni të rëndësishëm shkencor, jo vetëm se në vend e rajon, por edhe përtej Atlantikut. Për disa vjet me radhë (në periudhën 2017-2019), me bashkëpunëtorët e vetë organizoi manifestimin “Java kulturore shqiptare në SHBA”, ku pati promovime të shumta të librave të Institutit dhe ekspozita interesante tematike brenda komunitetit shqiptar dhe më gjerë në Nju Jork, Nju Xhersi, Stenton dhe Uashington. Tani botimet më reprezentative të Institutit gjenden nëpër bibliotekat dhe muzetë më prestigjioze amerikane, përfshirë edhe Bibliotekën e Kongresit Amerikan në Uashington.

4. Përfundim dhe propozim:

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dokumentacionin e dorëzuar dhe njohjen personale me kandidatin, bazuar në kualitetet e dëshmuara shkencore, publikimin e librave të shumta shkencore në fushën e historisë, organizimin e pjesëmarrjen aktive nëpër tubime të shumta shkencore, si dhe aktivitete të llojllojshme të veprimtarive tjera profesionale-aplikative, Komisioni recensues e vlerëson lartë punën dhe angazhimin e madh të kandidatit dr. Skender Asani gjatë kësaj periudhe.

Në bazë të të dhënave të paraqitura mbi aktivitetin e plotë të kandidatit që nga zgjedhja e tij e fundit e deri më sot, Komisioni ka konstatuar se dr. Skender Asani, posedon kualitete shkencore e profesionale, dhe në tërësi i plotëson kushtet për zgjedhje në thirrjen *Këshilltar shkencor / Profesor ordinar*, të parapara në Rregulloren për vërtetimin e kriterëve për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtoresh dhe shkencore në IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Ligjit për veprimtari hulumtuuese - shkencore. Nëpërmjet krahasimit të dokumentacionit të dorëzuar midis dy zgjedhjeve, si komision konstatuam se nuk ekziston përputhshmëri e referencave të parashtruara.

Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, t’i propozojë që dr. Skender Asani, të zgjidhet në thirrjen **KËSHILLTAR SHKENCOR / PROFESOR ORDINAR** në Departamentin e Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjeve demografike në ITShKSh - Shkup.

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Naim Alimi, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Zeqirja Idrizi, anëtar, d.v.
3. Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v.

Shtojcë:

FORMULAR
I RAPORTIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE

Kandidati: **Dr. Skender Asani**

Institucioni: IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup

Departamenti: Historia e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe Lëvizjeve Demografike

Tabela nr. 2

Nr. ren	VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE DHE VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	Pikët	
		vend.	ndërk
1.	Monografi		
	1. “Rrugëtimi - Патешествие - Journey”, në bashkautorësi me Albert Ramaj, ITShKSh & Acta Non Verba, Shkup, 2017;	6	
	2. “Dokumente, fotografi dhe dëshmi për familjet katolike Shqiptare në Shkup (Monografi I)”./ “Documents, Pictures And Testimonies For Catholic Albanian Families In Skopje (Monography) I”, në bashkautorësi me Albert Ramaj dhe Natasha Didenko, Acta Non Verba, Shkup, 2017;	4	
	3. “Dega e Shkupit e Lidhjes së Prizrenit dhe Jashar Bej Shkupi, (Pëmbledhje me Dokumente)”, ITShKSh, Shkup, 2018;	8	
	4. “Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar (1941-1944), në dritën e dokumenteve shqiptare” (përmbledhje me dokumente), në bashkautorësi me Sevdail Demiri, ITShKSh, Shkup, 2018;	6	
	5. “Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë” - me grup autorësh, ITSHKSH, Shkup, 2018;	4	
	6. “Shkupi për Vitin e Skënderbeut (1468-2018) / Скопје за годишнината на Скендербер (1468-2018) / Skopje for Skenderbeg Year (1468-2018), ITShKSh, Shkup, 2018;	4	
	7. “Familjet Katolike Shqiptare në Shkup – II”/ “Catholic Albanian Families In Skopje – II”, në bashkautorësi me Albert Ramaj dhe Nora Maliqi, ITShKSh, Shkup, 2018;	6	
	8. “Konti Bertold dhe çështja shqiptare”, në bashkautorësi me Qerim Lita, ITShKSh, Shkup, 2018;	6	
	9. “Kontesti Kufitar Ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së SKS-së (1919 – 1925), (dokumente), në bashkautorësi me Isamedin Azizi,	6	

	ITShKSh, Shkup, 2019;		
	10. “Legjislacioni bazik antisemitik në mbretërinë e Bullgarisë, përmbledhje dokumentesh” (shqip, maqedonisht, anglisht), në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali dhe Vllado Popovski, ITShKSh, Shkup, 2020;	6	
	11. “Nga Gonxhe Bojaxhiu deri te Nënë Tereza - Një sage për jetën e shqiptarëve katolikë të Shkupit –“ / “From Gonxhe Bojaxhiu to Mother Theresa - A saga about the life of Albanian Catholics from Skopje –“, në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali dhe Albert Ramaj, ITShKSh, Shkup, 2020;	6	
	12. “Ditari i Parashqevi Qiriazit, ditët e mija në Konferencën e Versajës, dokumente”, në bashkautorësi me Nora Maliqi Zylali, ITShKSh, Shkup, 2020;	6	
	13 “Strategjitë e të mësuarit për holokaustin në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Стратегии за учење на холокаустот во Република Северна Македонија”, në bashkautorësi, ITShKSh, Shkup, 2020;	6	
	14. “Adresat e reja të një kujtese”, ITShKSh, Shkup 2021;	8	
	<i>Gjithsej</i>	82	
2.	<i>Punim me rezultate origjinale shkencore i publikuar në revistë shkencore/ profesionale</i>		
	1. “E kaluara ngulfat të ardhmen e Maqedonisë”, Balkan Perspectives, No. 06 – 2016, Shkup, fq. 16 - 17;		6
	<i>Gjithsej</i>		6
3.	<i>Punim me rezultate origjinale shkencore i publikuar në përmbledhje të punimeve nga tubimi shkencor</i>		
	1. “Veprimtaria e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1985-1987”, në bashkautorësi me Halide Palloshi, Lëvizja, nr.3., Prizren, 2020;	3	
	2. “Gjendja e (mos) arsimimit në territoret verilindore shqiptare” (në bashkautorësi me Sevdail Demiri), SCUPI – 17, ITShKSh, Shkup, 2017;	3	
	3. “Shtypi shqiptar në Maqedoni për kërkesën ‘Kosova Republikë’, në vitet 1981-1982”, në bashkautorësi me Sevdail Demiri, Lëvizja, nr.2., Prishtinë, 2018, 161-165;	2	
	4. “Skënderbeu i ri (një interpretim ndryshe), “Studime Albanologjike” - 17, ITShKSh, Shkup, 2018,	3	
	5. “Burimet e hulumtuara për veprimtarinë politike të Xhemijetit”, “Kërkime Historike” – 9/10, Shkup, 2017,	3	
	6. “Familjet katolike shqiptare të Shkupit, në fokusin e historisë”, në bashkëautorsi me S. Demiri, Studime Muzeologjike, nr. 8., Tiranë, 2018;	2	

	7. “Vulën e kombndertimit të Shqiptarëve e bëri Kongresi i Manastirit”, Scupi – 23, ITShKSh, Shkup, 2018;	3	
	8. “Procese pozitive zor se do të mund të ndodhin, pa intervenimin energjik të NATO-s 20 vjet më parë”, Scupi – 25, ITShKSh, Shkup, 2019;	3	
	9. “Evropa një sallë operacioni ku vetem kirurgët amerikan kryejn punën”, Ditët e Alfabetit I, ITShKSh, Shkup 2020;	3	
	<i>Gjithsej</i>	25	
4.	<i>Pjesëmarrje me referat në konferencë/tribunë shkencore</i>		
	1. Kumtesë në simpoziumin shkencore të organizuar nga Shoqëria “Lëvizja”, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Instituti Albanologjik – Prishtinë, organizoi Simpozium shkencor, “Lëvizja e viteve 1985-1987 dhe mbledhja e saj e parë e përgjithshme”, 19.01.2019, ITShKSh, Prizren;	1.5	
	2. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, 06.03.2018, Prishtinë;	1.5	
	3. Kumtesë në simpoziumin shkencor të organizuar Shoqëria “Lëvizja”, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Instituti Albanologjik – Prishtinë, organizoi Simpozium shkencor, “Lëvizja Popullore e Kosovës në vitet 1982 – 1984 dhe heronjtë Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Bajram Bahtjari e Zija Shemsiu”, 25.01.2018, ITShKSh, Shkup;	1.5	
	4. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, 10.06 2018, Prizren.	1.5	
	5. Kumtesë në konferencën shkencore “Veprimtaria atdhetare e Shotë Galicës”, 21.12. 2017, Prishtinë.	1,5	
	6. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në 550 vjetorin e vdekjes”, 16.10. 2018, Prishtinë;	1,5	
	7. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Antifashizmi popullor tek shqiptarët në kuadër të 75 vjetorit të çlirimit”, 31.07. 2019, Tiranë;	1.5	
	8. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Komiteti mbrojtja kombëtare e Kosovës dhe koha e tij”, 02.05 2018, Tiranë;	1,5	
	9. Меѓународен научен симпозиум „Балканологија и современите предизвици,, 9-10.11.2018, Скопје;	1,5	
	10. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Fytyra e armikut të popullit gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri 1944 - 1990”, 19.05 2019, Tiranë;	1,5	
	11. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “110 vjetori të Kongresit të Manastirit”, 22.11 2018, Manastir;	1,5	

	<i>Gjithsej</i>	16,5	
5.	<i>Udhëheqës i projektit shkencor</i>		
	1. “Xhamitë dhe Teqetë në Shkup dhe rrethinë, në Periudhën në mes dy Luftërave Botërore, (Dokumente, Fotografi, Dëshmi)”, ITShKSh - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019;	6	
	2. “100 Years Wilson, Paris Peace Conference Albanian American Friendship”, ITShKSh, Komuna e Çairit, IAPS - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019;	6	
	3. “The Path of the Righteous – Holocaust Stories of Macedonia and Albania. Through the life of the survivors and Righteous”, ITShKSh - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019;	6	
	4. “Животот на Старата Скопска Чаршија низ вековите”, Acta Non Verba- projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2019;	6	
	5. “Zhvillimet kulturore – historike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut gjatë shek. XIX-XX” – projekt hulumtues trevjeçar i ITShKSh-së - Shkup (2021-vijim).	6	
	<i>Gjithsej</i>	30	
6.	<i>Qëndrim hulumtues shkencor, hulumtim arkivor / në terren (min. 1 javë)</i>		
	1. Qëndrim hulumtues në Itali – Arkivi i Punëve të jashtme të Italisë në Romë, 2019;		4
	2. Qëndrim hulumtues në Serbi – Arkivi Shtetëror i Serbisë – Beograd, 2019;		4
	3. Qëndrim hulumtues në Shqipëri – Arkivi i Ministrisë së punëve të jashtme të Shqipërisë – Tiranë, 2019;		4
	<i>Gjithsej</i>		12
7.	<i>Anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të magistraturës dhe doktoraturës</i>		
	1. Anëtar i komisionit të mbrojtjes së temës të magistraturës “Tetova me rrethinë në vitet 1918 – 1941”, të kandidatit Driton Osmani, Shkup, 2020;	0.5	
	2. Anëtar i komisionit të mbrojtjes së temës të magistraturës “Ndikimi i lajmeve të rreme në proceset zgjedhore në skenën politike ndërkombtare dhe ballkanike”, të kandidatit Arbër Shaqiri, Shkup 2020;	0.5	

	3. Anëtar i komisionit të mbrojtjes së temës të magjistraturës “Mbrojtja e të drejtave të njeriut, sipas konventave ndërkombëtare”, të kandidatit Lulzim Kashtanjeva, Shkup 2019;	0.5	
	4. Anëtar i komisionit të mbrojtjes së disertacionit të doktoraturës “Pozita e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918 – 1941” të kandidatit Besnik Rameti, Shkup 2020;	1	
	<i>Gjithsej</i>	2.5	
8.	Gjithsej pikë nga Tabela nr.1	156	18
		174	

Tabela nr. 3

Nr. ren	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	Pikët	
		Vend	Ndërk
1.	<i>Redaktor / anëtar i Këshillit redaktues të revistës shkencore ose i përmbledhjes së punimeve shkencore</i>		
	1. Ballkanologjia – 1, ITShKSh, Shkup, 2019;		2
	2. Ballkanologjia – 2, ITShKSh, Shkup, 2020;		2
	3. Scupi – 17: “75 vjetori i hapjes së Shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”, ITShKSh, Shkup, 2017;	1	
	4. Scupi – 18: “Festat e Kalendarit Popullor” ITShKSh, Shkup, 2017;	1	
	5. Scupi – 19: “Masar Kodra (1932–2003) – figurë e shquar e historiografisë shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	6. Scupi – 20: “Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	7. Scupi – 21: “Dita e Shëngjergjit në trevat shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	8. Scupi – 25: “NATO, Bllaca, Kosova”, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	
	9. Scupi – 26: “Dasma në trevat shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	
	10. Scupi – 28: “100 vjet Xhemijet”, ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	11 Arkivat shqiptare 1-2, viti 54/2018;	1	
	12. “Rekomandim për Mësimdhënien dhe Mësimnxënien mbi Holokaustin” grup autorësh (në katër gjuhë), IHRA / ITShKSh, Shkup, 2020;		2
<i>Gjithsej</i>	9	6	
2.	<i>Kryetar i Këshillit Organizues të tubimit shkencor</i>		
	1.”110 Vjetori i Lindjes së Nënës Terezë”, 26 gusht, 2020;	2	
	2. “Ekzodi i Bllacës 1999”, Shkup 2019;	2	
	3. “20 vjetorit i bombardimit të NATO-së”, Shkup, 2019;	2	

	4. “110 vjetori i Kongresit të Manastirit”, Shkup-Manastir 2018;	2	
	5. “111 vjetori i Kongresit të Manastirit”, Shkup-Manastir 2019;	2	
	6. “112 vjetori i Kongresit të Manastirit”, Shkup, 2020.	2	
	Gjithsej	12	
3.	<i>Drejtues i sesionit në konferencën / tribunën shkencore</i>		
	1. Drejtues i sesionit shkencor “110-vjetori i Kongresit të Manastirit”, ITShKSh, Akademia e Studimeve Albanologjike – Tiranë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë i Prishtinës, Instituti për Studime Protestante dhe Shqiptare, 21.11.2018, Manastir;	0.5	
	2. Drejtues i tribunës shkencore “20-vjetori i eksodit të shqiptarëve nga Kosova”, ITShKSh, 05.04.2019, Shkup;	0.5	
	3. Drejtues sesioni në manifestimin kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit-I”, 14-22.11.2019, ITShKSh, Manastir/Shkup;	0.5	
	4. Drejtues sesioni në edicionin “Ditët e Alfabetit-I”, 14.11.2020, ITShKSh, Shkup.	0.5	
	<i>Gjithsej</i>	2	
4.	<i>Pjesëmarrje në aktivitetet promovuese të Institutit</i>		
	1. Promovues i botimeve të Institutit në vitin 2016;	1	
	2. Promovues i botimeve të Institutit në vitin 2017;	1	
	3. Promovues i botimeve të Institutit në vitin 2018;	1	
	4. Promovues i botimeve të Institutit në vitin 2019;	1	
	5. Promovues i botimeve të Institutit në vitin 2020;	1	
	6. “Java kulturore shqiptare në SHBA” (promovime librash dhe ekspozita), ITShKSh, Nju Jork dhe Nju Xhersi, 2017;	1	
	7. “Java kulturore shqiptare në SHBA” (promovime librash dhe ekspozita), ITShKSh, Nju Jork dhe Nju Xhersi, 2018;	1	
	8. “Java kulturore shqiptare në SHBA” (promovime librash dhe ekspozita), ITShKSh, Stenton dhe Uashington, 2019.	1	
	<i>Gjithsej</i>	8	
5.	<i>Drejtor i Institutit</i>		
	Drejtor ITShKSh-së (2018 -në vijim)	6	
	<i>Gjithsej</i>	6	
6.	<i>Anëtar i komisioneve dhe trupave të organeve shtetërore dhe organeve të tjera</i>		
	1. Anëtar i Komisionit recensues të Ministrisë së Kulturës së RMV-së, për zgjedhje në tituj profesional në sferën e veprimtarisë bibliotekare (2016 - 2020);	1	
	2. Anëtar i Komisionit profesional në fushën e shkencës për ndarjen e Çmimit nga „22 Nëntori“ (2019); Ministria e Kulturës së RMV-së;	1	

	3. Anëtar i Komisionit profesional në fushën e shkencës për ndarjen e Çmimit nga „22 Nëntori“ (2020); Ministria e Kulturës së RMV-së;	1	
	4. Anëtar i Këshillit botues të pullave postare në Postën e Maqedonisë së Veriut – Shkup (2017 - 2020).	1	
	<i>Gjithsej</i>	4	
7.	<i>Anëtar i komisionit për zgjedhje në thirrje shkencore</i>		
	Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh, të kandidatit dr. Minir Ademi, 22.10.2018	0,5	
	Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh, të kandidatës dr. Teuta Agai-Demjaha, 16.12.2019	0,5	
	Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh, të kandidatës dr. Nora Maliqi Zylali, 16.09.2020.	0,5	
	<i>Gjithsej</i>	1.5	
8.	<i>Recensent i monografisë / veprës shkencore</i>		
	1. Mustafa Ibrahim, “Nënë Tereza në Filatelinë Botërore”, Shkup, 2017;	1	
	2. Mimi Kamhi Ergas – Faraxhi, “Jeta ime nën pushtimin nazist”/memoare/, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	3. Nebi Dervishi, “Manastiri - vatër e Rilindjes Kombëtare Shqiptare (shek. XIX deri në vitin 1912)”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	4. Halim Purellku, “Shkrime Historike”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	5. “Skënderbeu në vendet nordike” – Xhevat Lloshi & John Quanrud, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	6. “Myfit Sinojmeri (1923-1954), pishtar i arsimit” – Nebi Dervishi & Mehmet Latifi, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	7. Ali Vishko, “Shkrime Historike”, (Nën përkujdesjen e Prof. dr. Nebi Dervishit), ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	8. Anton Nikë Berisha, “Gonxhe Bojaxhiu- Nënë Tereze “E desha tjetrin me dashurinë e hyjit”, ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	9. “Trashëgimia kulturore dhe natyrore në Derven të Shkupit” - Besnik Rameti, ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	10. “Vepra e Anton Çettës për ligj qenësinë e trashëgimisë sonë” - Anton Nikë Berisha, ITShKSh, Shkup, 2020.	1	
	<i>Gjithsej</i>	10	
	Gjithsej pikë nga Tabela nr.2	52.5	6
		58.5	

REFERENCAT KUMULATIVE PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE TË KANDIDATIT DR. SKENDER ASANI	Pikët
Veprimtaria hulumtuese - shkencore dhe veprimtaria mësimore – shkencore (Pikët nga Tabela nr.2)	174
Veprimtaria profesionale - aplikative dhe veprimtaria me interes më të gjerë (Pikët nga Tabela nr.3)	58.5
GJITHSEJTË	232.5

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Naim Alimi, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Zeqirja Idrizi, anëtar, d.v.
3. Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v.

R E F E R A T
PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN KËSHILLTAR SHKENCOR NË
DEPARTAMENTIN E HISTORISË SË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË SË
VERIUT DHE LËVIZJEVE DEMOGRAFIKE NË ITSHKSH – SHKUP

Në bazë të konkursit publik të shpallur më 15.03.2021, në gazetata ditore “Lajm” dhe “Нова Македонија” për zgjedhjen e dy këshilltarëve shkencorë në Departamentin Historia e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjet demografike në IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh) në Shkup, Këshilli i Institutit në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 29.3.2021, me vendimin nr. 0201-195/2, ka zgjedhur për anëtarë të Komisionit recensues, në përbërje: kryetar prof. dr. Naim Alimi - këshilltar shkencor (ITShKSh - Shkup), dhe anëtarët prof. dr. Zeqirja Idrizi – profesor ordinar (Universiteti “Fadil Sulejmani” - Tetovë) dhe prof. dr. Qemal Murati - këshilltar shkencor (ITShKSh - Shkup). Si anëtarë të Komisionit recensues, kemi nderin që Këshillit të IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, t’i dorëzojmë këtë raport.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues konstaton se në konkursin publik për zgjedhje/rizgjedhje në thirrjen shkencore këshilltarë shkencorë në Departamentin e Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjet demografike në IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, janë paraqitur dy kandidatë: dr. Skender Asani - bashkëpunëtor i lartë shkencor, dhe dr. Sevdail Demiri – bashkëpunëtor i lartë shkencor. Ky raport i referohet kandidatit:

Dr. Sevdail Demiri, bashkëpunëtor i lartë shkencor.

1. Të dhënat biografike dhe arsimimi:

Kandidati dr. Sevdail (Faik) Demiri u lind më 20. 1. 1980 në Kumanovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Kumanovë, kurse studimet universitare në Fakultetin Filologjik të Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi” në Shkup (2006).

Në vitin 2008 i regjistroi studimet pasdiplomike në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup, në kuadër të Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi”, grupi Historia e diplomacisë së shteteve ballkanike, ku magjistroi në vitin 2011. Po aty, menjëherë u regjistrua në shkallën e doktoratës, dhe në vitin 2013 e mbrojti me sukses temën në fushën e historisë së shtypit shqiptar dhe e mori titullin *Doktor i shkencave historike*.

Kandidati Sevdail Demiri që në fillimet e karrierës së tij profesionale prej viteve të gjimnazit, është marrë aktivisht me gazetari dhe publicistikë, duke dhënë një kontribut të çmuar në mjete të ndryshme të informimit në vend për rreth 15 vjet.

Në fund të vitit 2013 u punësua në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, si bashkëpunëtor shkencor dhe më pas bashkëpunëtor i lartë shkencor në departamentin Historia e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjet demografike.

Në ndërkohë u angazhua si ligjërues i jashtëm i disa lëndëve në Kolegjin universitar UBT në Prishtinë, si dhe në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Në dy mandate ka udhëhequr me Klubin e Shkrimtarëve “Jehona e Karadakut” nga Kumanova, duke lënë gjurmë edhe në fushën e letërsisë shqipe.

Deri më tani ka botuar mbi dhjetë vepra autoriale dhe punime në fushën e historisë, publicistikës dhe letërsisë.

Me familjen jeton në Kumanovë.

2. Veprimtaria hulumtuese - shkencore:

Nga materialet e parashtruara, shihet se kandidati dr. Sevdail Demiri, që nga zgjedhja e fundit në thirrjen shkencore Bashkëpunëtor i lartë shkencor në Departamentin e Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjeve demografike në IPSh Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më datë 1.8.2016, ka treguar interes të vazhdueshëm në veprimtarinë hulumtuese-shkencore, ku ka arritur rezultate të çmueshme në fushën e shkencave historike dhe më gjerë. Bëhet fjalë për një kandidat shumë serioz, i cili përvojën e tij të mëparshme të kultivuar të shkrimit në fushën e gazetarisë dhe të letërsisë, me mjaft sukses e ka aplikuar në studimet e tij të fushës historiografike. Kontributi i tij për shkencën historike veçanërisht në këto pesë vitet e fundit, shihet qartë në shumë vepra të botuara shkencore, në punime shkencore të publikuara nëpër revista të ndryshme, në pjesëmarrjen në projekte të shumta hulumtuese - shkencore, në veprimtarinë mësimore-shkencore të aplikuar nëpër universitetet e Shkupit e Prishtinës, etj.

Siç u përmend, kandidati Sevdail Demiri, në periudhën ndërmjet dy zgjedhjeve në thirrje shkencore, ka botuar disa vepra të rëndësishme për shkencën historike, duke u koncentruar në problematika kryesisht vendore, gjë që tregojnë për intuitën e hollë shkencore dhe guximin intelektual për të trajtuar tema konkrete të historisë bashkëkohore nga treva ku jeton e vepron. Sevdail Demiri është autor i veprave: “Variacione historike“ (ShHShM, Shkup, 2017), ku spikasin tema të ndryshme shkencore historike të punuara ndër vite, si dhe vepra “Shqiptarët në rrjetën diplomatike të Republikës së Maqedonisë (1991-2011)” (ITShKSh, Shkup, 2018), ku përmes një përshkrimi argumentues historik të ngjarjeve, për herë të parë në mënyrë të dokumentuar sjell fakte për papërfaqësimin e duhur institucional të shqiptarëve në diplomaci gjatë viteve të para të demokracisë së shtetit të ri, deri në Marrëveshjen e Ohrit. Demiri, si bashkautor i parë ose i dytë paraqitet edhe në disa vepra të botuara nga ITShKSh - Shkup, si: monografia „10 vjet - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve“ (2017), përmbledhja me dokumente “Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar /1941-1944/, në dritën e dokumenteve shqiptare” (2018),

monografia shkencore “Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë” (2018), libri tregjuhësor “Shkupi për Vitin e Skënderbeut /1468-2018/” (2018), si dhe libri hulumtues nga fusha e trashëgimisë kulturore “Thesare kulturore dhe natyrore të trevës së Kumanovës” (2019). Në këto botime, autori me një stil të veçantë dhe shumë objektiv, u qaset temave nga historia kombëtare shqiptare dhe trashëgimia kulturore, mbështetur në dokumente autentike arkivore, shumica nga të cilët përdoren për herë të parë.

Në mesin e punimeve me rezultate origjinale shkencore të publikuara në revistë shkencore - profesionale, veçohen dy punime të botuara në revista shkencore me bord ndërkombëtar. Konkretisht, bëhet fjalë për punimin autorial me mjaft rëndësi për historinë e gazetarisë shqiptare: “Gazetat me histori - shkojnë në histori!” (Centrum, 9/2018), ku autori në veçanti shkruan për fatin e keq të gazetave tradicionale shqiptare në trekëndëshin Shkup - Prishtinë – Tiranë, të cilat u shuan pikërisht në kohën kur do të duhej të stimuloheshin më së shumti në punën e tyre. Dhe, punimi tjetër i shkruar në bashkautorësi: “Vlera kulmore nga trashëgimia materiale e trevës së Likovës e Kumanovës” (Studime Albanologjike, 19/2019), në mënyrë shkencore nxjerr në pah vlerat e mëdha të trashëgimisë kulturore materiale që i ka treva e Karadakut të Likovës dhe Kumanovës, të cilat po të trajtoheshin nga autoritetet përkatëse në dimensionin e duhur, do të bëheshin atraksione të përmasave botërore. Në këtë mënyrë, përmes publikimeve shkencore, autori kryen edhe një borxh qytetar ndaj rrethit ju jeton dhe vepron, duke sinjalizuar për dëmet që shkaktohen nga moskujdesi i duhur institucional, si dhe mundësitë e mëdha që ekzistojnë nëse shfrytëzohen si duhet potencialet e mëdha kulturore dhe natyrore.

Nga punimet tjera shkencore të botuara në përmbledhje të punimeve nga tubime shkencore, veçojmë: “Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës /1946-47/”, (Scupi – 16/2017); “Gjendja e (mos)arsimit në territoret verilindore shqiptare” /në bashkautorësi/, (Scupi – 17/2017); dhe “Shtypi shqiptar në Maqedoni për kërkesën ‘Kosova Republikë’, në vitet 1981-1982”, /në bashkautorësi/, (Lëvizja, nr.2., Prishtinë, 2018). Në këto punime të prezantuara edhe nëpër konferencat gjegjëse shkencore, përmes dokumenteve arkivore dhe dëshmimeve autentike, studiohen procese historike që kanë lënë gjurmë në memorien kolektive të shqiptarëve të këtyre trojeve. Veç kësaj, Demiri ka bërë edhe disa recensione të librave të ndryshme kryesisht të karakterit historik, nëpër revista dhe botime shkencore në Shkup e Tiranë, si në: “Studime Albanologjike”, “Studime Muzeologjike”, “Ballkanologjia”, etj.

Me mjaft rëndësi janë edhe pjesëmarrjet e drejtpërdrejta nëpër konferenca të shumta shkencore historike. Kështu, me kumtesë mori pjesë: në konferencën shkencore të mbajtur më 20.11.2016 në Shkup, me temë: “75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës dhe ITShKSh në Shkup; në konferencën shkencore ndërkombëtare mbajtur më 6.3.2018 në Prishtinë: “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë; në tribunën shkencore mbajtur më 11.11.2019 në Shkup: “Zhvillimi i kulturës mediatike dhe

promovimi i kulturës në media”, organizuar nga ITShKSh në Shkup; si dhe më 23.10.2020 në edicionin e tretë të konferencës shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia”, organizuar nga ITShKSh në Shkup.

Kandidati Sevdail Demiri, ka marrë pjesë në shumë projekte shkencore të Institutit, duke kryer hulumtime të dokumenteve nëpër arkivat e Shkupit e Tiranës, si dhe punë hulumtuese në terrenin e rajonit të Kumanovës. Ka qenë zëvendësudhëheqës i projektit shkencor të ITShKSh-së: “Trashëgimia kulturore dhe natyrore e rajonit të Kumanovës dhe Likovës”, i miratuar dhe mbështetur nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2018; udhëheqës i projektit shkencor individual: “Relikte banimi nga treva e Karadakut”, i miratuar poashtu nga Ministria e Kulturës dhe që është duke u realizuar gjatë këtij viti kalendarik. Poashtu, është pjesë edhe e projekt hulumtues trevjeçar të ITShKSh -Shkup (2021-vijim) me temë: “Zhvillimet kulturore – historike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut gjatë shek. XIX-XX”.

Në kuadër të ITShKSh -së funksionon edhe programi studimor i akredituar i magjistraturës “Histori dhe marrëdhënie ndërkombëtare”. Deri më tani, dr.Sevdail Demiri ka marrë pjesë në mbrojtje publike të temave të magjistraturës së katër kandidatëve, në rolin e anëtarit ose kryetarit të komisionit, gjë që flet për një përvojë të rëndësishme edhe në këtë sferë.

3. Veprimtaria profesionale - aplikative dhe veprimtaria me interes më të gjerë:

Kandidati Sevdail Demiri, përpos veprimtarisë së pasur hulumtuese – shkencore që e cekëm më lartë, ka arritur që me mjaft sukses t’i kultivojë përvojat e tij edhe në veprimtarinë profesionale - aplikative dhe veprimtari tjera me interes më të gjerë publik dhe shoqëror. Nga aktivitetet e vazhdueshme, duket qartë se është njëri nga punëtorët më aktivë në veprimtarinë e përgjithshme të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup, por edhe nëpër institucione tjera ku ka dhënë një kontribut të çmuar profesional.

Është kryeredaktor i tri përmbledhjeve me punime shkencore të edicionit të veçantë “Scupi” (nr. 16/2017, 17/2017, dhe 25/2019), ku janë trajtuar tema nga Lufta e Dytë Botërore dhe lufta e fundit e Kosovës e vitit 1999 me krizën humanitare. Është kryeredaktor i edicionit të parë të titulluar “Ditët e Alfabetit” (ITShKSh, Shkup, 2020), ku përfshihen materiale nga aktivitetet disaditore të manifestimit kulturor-shkencor me të njëjtin emër që është mbajtur në Shkup dhe Manastir në vitin paraprak. Sevdail Demiri përgatiti për botim tre edicione të veçanta të “Kalendarit Albanologjik” (ITShKSh, Shkup, 2019/2020/2021), ku përfshihen të gjitha aktivitetet shkencore dhe promovuese të Institutit gjatë një viti kalendarik. Në këtë aspekt, e gjejmë në rolin e redaktorit apo anëtarit të këshillit redaktues të dy numrave të revistës shkencore ndërkombëtare të ITShKSh-së: “Studime Albanologjike” (19/2019, 20/2020), i përmbledhjes së punimeve të konferencës shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia” (1/2019, 2/2020), si dhe anëtar i këshillit redaktues të shtatë edicioneve të “Scupi”-it që

botohet në kuadër të ITShKSh-së, me punime nga konferencat shkencore të organizuara nga ana e Institutit.

Që nga viti 2019, dr. Sevdail Demiri është angazhuar si ligjërues i jashtëm në Universitetin publik “Nënë Tereza” në Shkup, kryesisht brenda Fakultetit të Shkencave Sociale. Për disa semestra aty ligjëron lëndët “Menaxhimi dhe transformimi i konflikteve”, “Ndërveprimet kulturore në rajonin e Ballkanit”, dhe “Multikulturalizmi evropian”, duke përcjellë përgatitjen e tij shkencore dhe përvojën personale të gjeneratave të reja të studentëve të këtij universiteti publik.

Në këtë periudhë gati pesëvjeçare, kandidati ka marrë pjesë në promovimin e katër monografive shkencore, në disa raste ka qenë moderator apo drejtues i sesioneve nëpër konferenca e tribuna të ndryshme shkencore, dhe ka marrë pjesë me vështrime dhe recensione në disa aktivitete tjera promovuese të Institutit në Shkup, Tiranë, Prishtinë, Uashington e Nju Jork. Ka qenë recensent i 14 veprave shkencore të botuara kryesisht nga ana e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup.

Në kuadër të veprimtarisë me interes më të gjerë, dhe në funksion të mbarëvajtjes së punëve brenda Institutit, Sevdail Demiri në rolin e redaktorit, vite me radhë ka mirëmbajtur ueb-faqen e Institutit (www.itsh.edu.mk), duke e ushqyer vazhdimisht me informacione nga aktivitetet e vazhdueshme shkencore. Një kontribut të çmueshëm ka dhënë në fushën e veprimtarisë botuese të Institutit në rolin e përgjegjës të Sektorit të Botimeve, me çka brenda një viti kalendarik janë botuar 20 deri në 30 botime të ndryshme shkencore, si libra, revista, përmbledhje me punime nga konferencat shkencore, etj.

Prej vitit 2017, dr. Sevdail Demiri udhëheq me sukses organin më të lartë të institucionit ku punon, pra është kryetar i Këshillit të Institutit Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup. Ndërsa, në suaza të përgjegjësisë shoqërore jashtë institucionit amë, ai ka marrë pjesë në disa komisione të rëndësishme profesionale shtetërore. Ka qenë anëtar i Komisionit recensues të Ministrisë së Kulturës për zgjedhjen e kuadrove në tituj profesional në sferën e veprimtarisë bibliotekare (2016-2020), anëtar i Këshillit për ndarjen e Çmimit shtetëror “Shën Klimenti i Ohrit” në Ministrinë e Kulturës (2016-2017), anëtar i Komisionit profesional në fushën e shkencës për ndarjen e Çmimit të Qytetit të Shkupit „13 Nëntori“ (2017), anëtar i Këshillit për ndarjen e Çmimit të Qytetit të Shkupit „13 Nëntori“ (2018-2020), anëtar i Komitetit programor në kuadër të Programit të Bashkimit Evropian për hulumtime dhe inovacione “Horizont 2020” me qendër në Bruksel, etj.

4. Përfundim dhe propozim:

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dokumentacionin e dorëzuar dhe njohjen personale me kandidatin, bazuar në kualitetet e dëshmuara shkencore, publikimin e librave dhe punimeve shkencore në fushën e historisë dhe më gjerë, pjesëmarrjen nëpër tubime të shumta shkencore, veprimtarinë arsimore dhe aktivitete

të llojllojshme të veprimtarive tjera profesionale-aplikative, Komisioni recensues e vlerëson lartë punën dhe angazhimin serioz të kandidatit dr. Sevdail Demiri gjatë kësaj periudhe gati pesëvjeçare.

Në bazë të të dhënave të paraqitura mbi aktivitetin e plotë të kandidatit që nga zgjedhja e tij e fundit e deri më sot, Komisioni ka konstatuar se dr. Sevdail Demiri, posedon kualitete shkencore e profesionale, dhe në tërësi i plotëson kushtet për zgjedhje në thirrjen *Këshilltar shkencor / Profesor ordinar*, të parapara në Rregulloren për vërtetimin e kriterëve për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtoresh dhe shkencore në IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Ligjit për veprimtari hulumtuuese - shkencore. Nëpërmjet krahasimit të dokumentacionit të dorëzuar midis dy zgjedhjeve, si komision konstatuam se nuk ekziston përputhshmëri mes referencave të parashtruara.

Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, t'i propozojë që dr. Sevdail Demiri, të zgjidhet në thirrjen **KËSHILLTAR SHKENCOR / PROFESOR ORDINAR** në Departamentin e Historisë së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe lëvizjeve demografike në ITShKSh - Shkup.

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Naim Alimi, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Zeqirja Idrizi, anëtar, d.v.
3. Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v.

Shtojcë:

FORMULAR
I REFERATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE

Kandidati: **Dr. Sevdail Demiri**

Institucioni: IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup

Departamenti: Historia e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe Lëvizjeve Demografike

Tabela nr. 2

Nr. ren	VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE	Pikët	
		vend.	ndërk
1.	<i>Monografi</i>		
	1. “Variacione historike“, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2017;	8	
	2. „10 vjet - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve” (monografi), ITShKSh, Shkup, 2017	4	
	3. “Shqiptarët në rrjetën diplomatike të Republikës së Maqedonisë (1991-2011)” (studim), ITShKSh, Shkup, 2018;	8	
	4. “Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar (1941-1944), në dritën e dokumenteve shqiptare”, në bashkautorësi me Skender Asanin, ITShKSh, Shkup, 2018;	6	
	5. “Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë” - me grup autorësh, ITShKSh, Shkup, 2018;	4	
	6. “Shkupi për Vitin e Skënderbeut (1468-2018) / Скопје за годишнината на Скендербег (1468-2018) / Skopje for Skenderbeg Year (1468-2018), ITShKSh, Shkup, 2018;	4	
	7. “Thesare kulturore dhe natyrore të trevës së Kumanovës”, në bashkautorësi me Naim Halimin, ITShKSh, Shkup, 2019.	6	
	<i>Gjithsej</i>	40	
2.	<i>Punim me rezultate origjinale shkencore i publikuar në revistë shkencore/ profesionale</i>		
	1. “Gazetat me histori - shkojnë në histori!”, Centrum, No. 9 – 2018, Shkup, UDC: 070(091), fq. 368-378;		6
	2. “Vlera kulmore nga trashëgimia materiale e trevës së Likovës e Kumanovës”, në bashkautorësi me Bunjamin Xhemailin, “Studime Albanologjike” - 19, ITShKSh, Shkup, 2019, 114-128;		5

	3. “Jehona e artit e kulturës shqiptare në Karadakun e Kumanovës”, Ars Albanica, viti I - nr.2, Tetovë, 2018, 109-114.	2	
	<i>Gjithsej</i>	2	11
3.	<i>Punim me rezultate origjinale shkencore i publikuar në përmbledhje të punimeve nga tubimi shkencor</i>		
	1. “Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës (1946-47)”, “Scupi” – 16, ITShKSh, Shkup, 2017, fq.99-105;	3	
	2. “Gjendja e (mos)arsimimit në territoret verilindore shqiptare” (në bashkautorësi me S.Asani), “Scupi”–17, ITShKSh, Shkup, 2017, fq.145-150;	3	
	3. “Shtypi shqiptar në Maqedoni për kërkesën ‘Kosova Republikë’, në vitet 1981-1982”, në bashkautorësi me S.Asani, “Lëvizja”, nr.2, Prishtinë, 2018, fq. 161-165.	2	
	<i>Gjithsej</i>	8	
4.	<i>Recension i librit në revistë shkencore</i>		
	1. “Rrugëtimi drejt Shqipërisë – ‘Parajsës Hebreje’ gjatë Holokaustit” (recension rreth librit “Rrugëtimi – Патешествие - Journey”, Skender Asani & Albert Rama), “Studime Albanologjike” - 16, ITShKSh, Shkup, 2017, fq. 203-204;	0,5	
	2. “Risi dokumentare për Xhemijetin” (recension), “Scupi” – 20, ITShKSh, Shkup, 2018, fq.19-21;	0,5	
	3. “Familjet katolike shqiptare të Shkupit, në fokusin e historisë”, recension në bashkautorësi me S.Asani, “Studime Muzeologjike”, nr.8, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 2018, fq.103-116;	0,5	
	4. “Një kontribut i veçantë i Shkupit për Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut”, edicioni “Ballkanologjia”-1, ITShKSh, 2019, fq.431-433;	0,5	
	5. “Brenda kullës sonë artistike” (rreth librit “Kulla jonë - Panoramë e poezisë kumanovare shqipe”), revista “Doruntina”, nr.59, “Jehona e Karadakut”, Kumanovë, 2020, fq.123-128.	0,5	
	6. ”Studim që ndriçon veprën e papërsëritshme të Anton Çettës” (Recension rreth librit “Vepra e Anton Çettës për ligj qenësinë e trashëgimisë sonë” të autorit Anton Nikë Berisha, botoi ITShKSh – Shkup 2020), portali “Fjala e Lirë”: https://fjala.info/studim-qe-ndricon-vepren-e-paperseritshme-te-anton-cettes/ 28.02.2021;	0,5	
	<i>Gjithsej</i>	3	
5.	<i>Pjesëmarrje me referat në konferencë/tribunë shkencore</i>		
	1. Kumtesë në konferencën shkencore: “75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”, Instituti Albanologjik – Prishtinë, Qendra e Studimeve	1.5	

	Albanologjike - Tiranë, ITShKSh – Shkup, 20.11.2016, Shkup;		
	2. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, 06.03.2018, Prishtinë;	1.5	
	3. Kumtesë në kuadër të projektit: “Zhvillimi i kulturës mediatike dhe promovimi i kulturës në media”, 11.11.2019, ITShKSh, Shkup;	1.5	
	4. Kumtesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia”- edicioni III, 23.10.2020, ITShKSh, Shkup.	1.5	
	<i>Gjithsej</i>	6	
6.	<i>Udhëheqës i projektit shkencor</i>		
	1. “Trashëgimia kulturore dhe natyrore e rajonit të Kumanovës dhe Likovës” (bashkëautorësi me N.Halimi), ITShKSh - projekt shkencor i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2018	4	
	2. “Relikte banimi nga treva e Karadikut”, projekt shkencor (individual) i miratuar nga Ministria e Kulturës e RMV-së, 2021.	6	
	<i>Gjithsej</i>	10	
7.	<i>Pjesëmarrës në projekt shkencor</i>		
	1. “Zhvillimet kulturore – historike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut gjatë shek. XIX-XX” – projekt hulumtues trevjeçar i ITShKSh -Shkup (2021-2023).	3	
	<i>Gjithsej</i>	3	
8.	<i>Anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të magistraturës</i>		
	1. Kryetar i komisionit për mbrojtjen e temës së magistraturës së kandidatit M.Dardhishta: “Historia e Kombeve të Bashkuara dhe sfidat e saj sot”, ITShKSh -Shkup, 15.07.2019;	0.5	
	2. Anëtar i komisionit për mbrojtjen e temës së magistraturës së kandidatit B.Emini: “Emigracioni – dikur dhe sot, me fokus Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë”, ITShKSh - Shkup, 15.07.2019;	0.5	
	3. Anëtar i komisionit për mbrojtjen e temës së magistraturës së kandidatit A.Idrizi: “Interpoli dhe Maqedonia e Veriut, historia dhe bashkëpunimi”, ITShKSh -Shkup, 20.07.2020;	0.5	
	4. Anëtar i komisionit për mbrojtjen e temës së magistraturës së kandidatit A.Shaqiri: “Ndikimi i lajmeve të rreme në proceset zgjedhore në skenën politike ndërkombëtare dhe ballkanike”, ITShKSh-Shkup, 25.12.2020;	0.5	
	<i>Gjithsej</i>	2	
9.	Gjithsej pikë nga Tabela nr.2	73	11
		85	

Tabela nr. 3

Nr. ren	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	Pikët	
		Vend	Ndërk
1.	<i>Kryeredaktor i revistës shkencore ose i përmbledhjes së punimeve shkencore</i>		
	1. “Scupi” – 16: “70–vjetori i Kongresit II (IV) të NDSH–së në Shkup”, ITShKSh, Shkup, 2017;	2	
	2. “Scupi” – 17: “75–vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë perëndimore”, ITShKSh, Shkup, 2017;	2	
	3. “Scupi” – 25: “NATO, Bllaca, Kosova”, ITShKSh, Shkup, 2019;	2	
	4. “Ditët e Alfabetit” – 1, ITShKSh, Shkup, 2020;	2	
	5. “Kalendari Albanologjik” – 1, ITShKSh, Shkup, 2019;	2	
	6. “Kalendari Albanologjik” – 2, ITShKSh, Shkup, 2020;	2	
	7. “Kalendari Albanologjik” – 3, ITShKSh, Shkup, 2021;	2	
	<i>Gjithsej</i>	14	
2.	<i>Redaktor / anëtar i Këshillit redaktues i revistës shkencore ose i përmbledhjes së punimeve shkencore</i>		
	1. “Studime Albanologjike” – 19, ITShKSh, Shkup, 2019;		2
	2. “Studime Albanologjike” – 20, ITShKSh, Shkup, 2020;		2
	3. “Ballkanologjia” – 1, ITShKSh, Shkup, 2019;		2
	4. “Ballkanologjia” – 2, ITShKSh, Shkup, 2020;		2
	5. “Scupi” – 19: “Masar Kodra (1932–2003) – figurë e shquar e historiografisë shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	6. “Scupi” – 20: “Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	7. “Scupi” – 21: “Dita e Shëngjergjit në trevat shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	8. “Scupi” – 23: “110 vjet alfabet shqip”, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	9. “Scupi” – 26: “Dasma në trevat shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	
	10. “Scupi” – 28: “100 vjet Xhemijet”, ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	11. “Scupi” – 29: “Veshjet tradicionale në trevat shqiptare”, ITShKSh, Shkup, 2020.	1	
	<i>Gjithsej</i>	7	8
3.	<i>Mësim / ligjërata në institucionet e arsimit të lartë në ciklin e parë/ të dytë/ të tretë 0,04/ 0,05/ 0,06 x numri i orëve në javë x numri i javëve (15)</i>		
	1. Menaxhimi dhe transformimi i konflikteve, FShS – Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup (2019/2020), 4 orë në javë (60x0,04=2,4);	2,4	

	2. Ndërveprimet kulturore në rajonin e Ballkanit, FShS – Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup (2019/2020), 3 orë në javë (45x0,04=1,8);	1,8	
	3. Menaxhimi dhe transformimi i konflikteve, FShS – Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup (2020/2021), 2 orë në javë (30x0,04=1,2)	1,2	
	4. Multikulturalizmi evropian, FShS & FShT - Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup (2020/2021), 2 orë në javë (30x0,04=1,2);	1,2	
	5. Ndërveprimet kulturore në rajonin e Ballkanit, FShS – Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup (2020/2021), 3 orë në javë (45x0,04=1,8).	1,8	
	<i>Gjithsej</i>	8,4	
4.	<i>Promotor i monografisë</i>		
	1. Vështrim në promovimin e librit të autorit Emin Azemi “Bllaca, dhimbja e lirisë”, ITShKSh, 12.04.2019, Shkup;	0.5	
	2. Vështrim në promovimin e librit të autorit Emin Azemi “Bllaca, dhimbja e lirisë”, dhe elaboratit të Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit “Bllacë 99”, ITShKSh, 21.06.2019, Prishtinë;	0.5	
	3. Vështrim në promovimin e librit të autorit Kristo Dako “Albania, the master key to the near east” (Boston, 1919), botim anastatik i ITShKSh dhe ISShP, 2019, 25.06.2019, Shkup;	0.5	
	4. Vështrim në promovimin e veprës së autorit Ilir Zylfiu: “Shqiptarësia e Luginës së Preshevës ndër shekuj”, ITShKSh, 05.10.2019, Preshevë.	0.5	
	<i>Gjithsej</i>	2	
5.	<i>Moderator dhe drejtues i sesionit në konferencë / tribunë shkencore</i>		
	1. Drejtues i sesionit shkencor “110-vjetori i Kongresit të Manastirit”, ITShKSh, ASHSh - Akademia e Studimeve Albanologjike – Tiranë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë i Prishtinës, Instituti për Studime Protestante dhe Shqiptare, 21.11.2018, Manastir;	0.5	
	2. Drejtues i tryezës shkencore “110-vjetori i Klubit Shqiptar të Kumanovës”, KSh “Jehona e Karadakut”, 10.03.2019, Kumanovë;	0.5	
	3. Drejtues i tribunës shkencore “20-vjetori i eksodit të shqiptarëve nga Kosova”, ITShKSh, 05.04.2019, Shkup;	0.5	
	4. Referues në manifestimin kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit-I”, 14-22.11.2019, Manastir/Shkup;	0.5	
	5. Promotor i edicionit “Ditët e Alfabetit-I”, 14.11.2020, ITShKSh, Shkup.	0.5	
	<i>Gjithsej</i>	2,5	
6.	<i>Pjesëmarrje në aktivitetet promovuese të Institutit</i>		

	1. Vështrim në promovimin e dy vëllimeve të veprës së autorit Skender Asani “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore”, ITShKSh dhe Logos-A, 01.11.2016, Shkup;	1	
	2. Vështrim rreth ekspozitës dhe librit dokumentar “Rrugëtimi – Патешествие – Journey”, ITShKSh dhe Acta Non Verba, 09.05.2017, Nju Jork - ShBA;	1	
	3. Vështrim rreth ekspozitës dhe librit dokumentar “Rrugëtimi – Патешествие – Journey”, ITShKSh dhe Acta Non Verba, 09.11.2017, Prishtinë – Kosovë;	1	
	4. Vështrim në promovimin e veprave të autorit Skender Asani: “Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore – 1919-1925” dhe “Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit”, ITShKSh - “Logos-A”, 17.12.2017, Shkup;	1	
	5. Vështrim rreth librave të autorëve Xhevat Lloshi e Xhon Kuanrud: “Skënderbeu në vendet nordike”, si dhe “Shkupi për Vitin e Skënderbeut (1468-2018)”, ITShKSh dhe Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 03.07.2018, Nju Xhersi – ShBA;	1	
	6. Vështrim në promovimin e veprave të autorit Skender Asani: “Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore – 1919-1925” dhe “Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit”, ITShKSh - “Logos-A”, 04.07.2018, Nju Xhersi – ShBA;	1	
	7. Vështrim rreth botimit: “Shkupi për Vitin e Skenderbeut (1468-2018)”, Seminari Ndërkombëtar i Ballkanologjisë, ITShKSh, 23.10.2018, Shkup;	1	
	8. Promotor i edicionit “Ballkanologjia -1”, në Seminarin Ndërkombëtar të Ballkanologjisë II, ITShKSh, 26.10.2019, Shkup;	1	
	9. Përgatitja e broshurës “Qendra Përkujtimore e Gjenocidit – Bllacë 1999”, ITShKSh, Shkup – Prishtinë, 2019	1	
	10. “Java kulturore shqiptare në SHBA” (promovime librash dhe ekspozita), ITShKSh, Stenton dhe Uashington, 2019.	1	
	<i>Gjithsej</i>	10	
7.	<i>Redaktor i ueb-faqes së Institutit</i>		
	Redaktor i ueb-faqes së ITShKSh-së: www.itsh.edu.mk	1	
8.	<i>Përgjegjës i Sektorit të Botimeve</i>		
	Përgjegjës i Sektorit të Botimeve të ITShKSh-së	3	
9.	<i>Kryetar i Këshillit të Institutit</i>		
	Kryetar i Këshillit të ITShKSh-së (2017 - vijim)	4	
10.	<i>Anëtar i komisioneve dhe trupave të organeve shtetërore dhe organeve të tjera</i>		
	1. Anëtar i Komisionit recensues të Ministrisë së Kulturës së RMV-së,	1	

	për zgjedhje në tituj profesional në sferën e veprimtarisë bibliotekare (2016- 2020), Shkup;		
	2. Anëtar i Këshillit për ndarjen e Çmimit shtetëror për arsim dhe shkencë “Shën Klimenti i Ohrit” në Ministrinë e Kulturës (2016-2017), Shkup	1	
	3. Anëtar i Komisionit profesional në fushën e shkencës për ndarjen e Çmimit të Qytetit të Shkupit „13 Nëntori“ (2017), Shkup;	1	
	4. Anëtar i Këshillit për ndarjen e Çmimit të Qytetit të Shkupit „13 Nëntori“ (2018-2021), Shkup;	1	
	5. Anëtar i Komitetit programor të MASH në kuadër të Programit të Bashkimit Evropian për hulumtime dhe inovacione “Horizont 2020”, Bruksel.		2
	<i>Gjithsej</i>	4	2
11.	<i>Anëtar i komisionit për zgjedhje në thirrje shkencore</i>		
	Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh, të kandidatit dr. Minir Ademi, 22.10.2018	0,5	
	Anëtar i komisionit recensues për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh, të kandidatit dr. Besnik Rameti, 28.9.2020	0,5	
	<i>Gjithsej</i>	1	
12.	<i>Recensent i monografisë / veprës shkencore</i>		
	1. “Studime historike dhe etnologjike në trojet tona etnike” – Naim Halimi, ITShKSh, Shkup, 2017;	1	
	2. “Rrugëtimi - Патешествие - Journey” – Skender Asani & Albert Ramaj, ITShKSh & Acta Non Verba, Shkup, 2017;	1	
	3. “Shqiptarët e Maqedonisë në trojet rumune” – Baki Ymeri, ITShKSh, Shkup, 2017;	1	
	4. “Trajtesa identitare” – Sefer Tahiri, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	5. “Skënderbeu në vendet nordike” – Xhevat Lloshi&John Quanrud, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	6. “Konti Bertold dhe çështja shqiptare”- Qerim Lita & Skender Asani, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	7. “Myfit Sinojmeri (1923-1954), pishtar i arsimit” – Nebi Dervishi & Mehmet Latifi, ITShKSh, Shkup, 2018;	1	
	8. “Figura e Adem Jasharit” – Fehmi Ajvazi, ShB Lena, Prishtinë, 2018;	1	
	9. “Arsimi dhe kultura shqiptare në Maqedoni (1944-1960)” – Minir Ademi, Kumanovë, 2018;	1	
	10. “Shqiptarësia e Luginës së Preshevës ndër shekuj” – Ilir A. Zylfiu, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	
	11. “Bllaca–dhimbja e lirisë” – Emin Azemi, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	
	12. “Pushtetndarja si instrument paqeje në Ballkan” – Isamet Bakiu, ITShKSh, Shkup, 2019;	1	

	13. "Trashëgimia kulturore dhe natyrore në Derven të Shkupit" - Besnik Rameti, ITShKSh, Shkup, 2020;	1	
	14. "Vepra e Anton Çettës për ligj qenësinë e trashëgimisë sonë" - Anton Nikë Berisha, ITShKSh, Shkup, 2020.	1	
	<i>Gjithsej</i>	14	
13.	Gjithsej pikë nga Tabela nr.3	70,9	10
		80,9	

REFERENCAT KUMULATIVE PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE TË KANDIDATIT DR. SEVDAIL DEMIRI :	Pikët
Veprimtaria hulumtuese - shkencore (Pikët nga Tabela nr.2)	85
Veprimtaria profesionale - aplikative dhe veprimtaria me interes më të gjerë (Pikët nga Tabela nr.3)	80,9
GJITHSEJTË	165,9

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Naim Alimi, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Zeqirja Idrizi, anëtar, d.v.
3. Prof. dr. Qemal Murati, anëtar, d.v.

R E F E R A T
PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN KËSHILLTAR SHKENCOR NË
DEPARTAMENTIN LIDHJEVE TË NDËRSJELLA KULTURORE, HISTORIKE
DHE GJUHËSORE MIDIS SHQIPTARËVE DHE MAQEDONASVE DHE
POPUJVE TJERË TË RAJONIT NË ITSHKSH – SHKUP

Në bazë të konkursit të shpallur publik më 15.03.2021, në gazetata ditore “Lajm” dhe “Нова Македонија” për zgjedhjen e një këshilltari shkencor në Departamentin e Lidhjeve të Ndërsjella Kulturore, Historike dhe Gjuhësore midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe Popujve tjerë të Rajonit, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup në mbledhjen e mbajtur më datën 29.3.2021, me vendimin numër 0201-195/3, na zgjodhi për anëtarë të Komisionit recensues në përbërje: Prof. dr. Qemal Murati, kryetar (Institutit i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore- Shkup pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës), Prof. dr. Liljana Siljanovska (Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë) dhe Prof. dr. Izaim Murtezani (Institutit i Folklorit “Marko Cepenkov”- Shkup).

Pasi Komisioni recensues e shqyrtoi dokumentacionin e ofruar, konstatoi se për thirrjen këshilltar shkencor në Departamentin e Lidhjeve të Ndërsjella Kulturore, Historike dhe Gjuhësore midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe Popujve tjerë të Rajonit në ITShKSh – Shkup, është paraqitur vetëm një kandidat:

Dr. Sefer Tahiri, bashkëpunëtor i lartë shkencor.

1. Të dhënat biografike dhe arsimimi:

Sefer Tahiri u lind në 26.1.1977 në fshatin Radushë- Shkup. Në fshatin e lindjes ka përfunduar arsimin fillor, ndërsa arsimimin e mesëm në gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup, drejtimi i gazetarisë, duke marrë titullin gazetar i diplomuar. Studimet pasdiplomike i ka përfunduar në Institutin e Hulumtimeve Sociologjike, Juridike dhe Politike në Shkup, fusha - komunikim. Në datën 28.5.2008 ka mbrojtur punimin e magistraturës në temën “Ndikimi i partive politike ndaj politikës editoriale të televizioneve komerciale në Maqedoni” duke marrë titullin magjistër i komunikimit. Përderisa në 29.9.2011 në Universitetin “Nju Jork”- Shkup, me sukses ka mbrojtur disertacionin e doktoraturës me temë “Ndikimi i partive politike ndaj politikës editoriale të Shërbimit radiodifuziv publik”, duke marrë titullin doktor i komunikimit.

Në 1 gusht të vitit 2016 është zgjedhur në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup,

Departamenti i *Lidhjeve të Ndërsjella Kulturore, Historike dhe Gjuhësore midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe Popujve tjerë të Rajonit.*

Nga data 1.9.2008 është angazhuar në pozitën e ligjëruesit në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, programi studimor “Komunikim” në lëndët: Hyrje në studimet e medias, Të shkruarit mediatik, Kriticizmi mediatik, Marrëdhënie me publikun dhe Të folurit publik. Nga viti 2006 deri në vitin 2008 ka qenë zëvendëskryeredaktor, redaktor i lajmeve dhe redaktor i emisionit informativ - politik “Studio e hapur” në Televizionin Alsat M. Në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2006 ka qenë gazetar dhe redaktor i lajmeve në Programin në gjuhën shqipe të Televizionit Maqedonas. Nga viti 2000 deri në vitin 2010 ka punuar korrespondent nga Maqedonia e Radios Evropa e Lirë, me seli në Pragë. Nga viti 1998 deri në vitin 2000 ka qenë gazetar dhe redaktor i rubrikës: politika e brendshme në gazetën e përditshme “Fakti”. Nga viti 2002 deri në vitin 2003 ka qenë edhe gazetar në javoren në gjuhën shqipe “Lobi”. Në vitin 2007 ka qenë anëtar i Këshillit të Nderit pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, ndërsa nga viti 2014 është anëtar i Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni.

2. Veprimtaria hulumtuese - shkencore:

Veprimtaria shkencore e dr. Tahirit në gjithë këto pesë vite, prej zgjedhjes së tij në thirrjen bashkëpunëtor i lartë shkencor ka qenë e orientuar në hulumtime interdisciplinare dhe në publikimin e punimeve nga fusha e komunikimit dhe interkulturës, veçanërisht duke u fokusuar në mënyrë serioze dhe analitike në raportimin mediatik të diversiteteve. Në punimet shkencore ai në mënyrë kritike, analitike dhe interpretuese i qaset mënyrës se si mediat raportojnë për specifikat e identitetit të komuniteteve dhe grupeve të caktuara, duke konstatuar se raportimi joobjektiv, në të cilin manifestohen paragjykime dhe stereotipe, ndërsa shpesh edhe gjuhë e urrejtjes duhet të zëvendësohet me raportim objektiv dhe të paanshëm, i cili nuk përmban motive etnike, fetare, ideologjike, politike dhe motive tjera.

Për shkak të natyrës, funksionit dhe misionit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup dhe për shkak të faktit se nga viti 2018 e kryen funksionin sekretar shkencor i ITShKSh-së, rregullisht ka qenë i përfshirë jo vetëm në organizimin e takimeve, por me punimet e tij shkencore të karakterit interdisciplinar ka kontribuar që të njëjtat të jenë në funksion të promovimit, afirmimit, kultivimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Theksojmë se dr. Tahiri trajton tema të rëndësishme nga aspekti akademik dhe shoqëror. Aspekti shoqëror ka të bëjë me faktin që temat të cilat i trajton kanë rëndësi e ndikim dhe janë me interes publik. Ndërsa arsyeshmëria akademike qëndron në origjinalitetin e punimeve, ndërsa metodologjikisht shumica bazohen në intervista të thelluara dhe në analizën e përmbajtjes përkatësisht analizën e raporteve, publikimeve, dokumenteve si dhe analizën e të dhënave sekondare nga hulumtimet e realizuara më parë.

a) Përshkrimi i punimeve shkencore:

Monografitë/ veprat shkencore

- “Rruga e kampionit olimpik Shaban Tërstena”, viti 2017;

- “Trajtesa identitare”, ITShKSh-Shkup, viti 2018;

-“Raportimi në interes të publikut - mbrojtja e parimeve etike në raportim përmes punës së Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media” (koautor i publikimit), KEM, viti 2017.

-“Maqedonia nga Bukureshti deri te Prespa - dëshmi të një kohe: Maqedonia 2008-2018” (koautor i publikimit), Fondacioni Shoqëria e Hapur -Shkup, viti 2020;

-“Midis shoqërisë së ndarë dhe një shoqërie - reflektime maqedonase” (koautor i publikimit), Avant pres, viti 2021.

Punime të publikuara shkencore:

-Mediat dhe komunikimi ndërkulturor në Ballkan, "Ballkanologjia 1", ITShKSh - Shkup, 2019;

-Shqiptarët dhe maqedonasit në diskursin mediatik dhe politik në Maqedoninë e Veriut nga periudha e pluralizmit deri më sot, "Ballkanologjia 2", ITShKSh -Shkup, 2020;

-Roli i mediave në përhapjen e stereotipave fetare dhe islamofobisë në Republikën e Maqedonisë, revista shkencore "Centrum", numër 8;

-Statusi juridik - kushtetues i shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, "Studime albanologjike", ITShKSh-Shkup, numër 20.

b) Pjesëmarrës në projekte hulumtuese - shkencore

Udhëheqës i projekteve të mbështetura nga Ministria e Kulturës:

-“Java e trashëgimisë kulturore - Festat e kalendarit popullor” (maj, viti 2017). Në kuadër të këtij projekti, në Strugë u organizua tribunë shkencore me temën: “Festat e kalendarit popullor”, në të cilën morën pjesë hulumtues shkencorë nga sfera e etnologjisë dhe folklorit.

-“Java e trashëgimisë kulturore - Dita e Shëngjergjit në trevat shqiptare” (maj, viti 2018). Në kuadër të këtij projekti, në Tetovë u organizua tribunë shkencore me temën: “Dita e Shëngjergjit në trevat shqiptare”, në të cilën morën pjesë hulumtues shkencorë nga sfera e etnologjisë dhe folklorit.

-“Java e trashëgimisë kulturore - Dasma në trevat shqiptare” (maj, viti 2019). Në kuadër të këtij projekti, në ITShKSh - Shkup u organizua tribunë shkencore me temën: Dasma në trevat shqiptare, në të cilën morën pjesë hulumtues shkencorë nga sfera e etnologjisë dhe folklorit.

-“Java e trashëgimisë kulturore - Veshjet tradicionale në trevat shqiptare” (viti 2020). Në kuadër të këtij projekti, në ITShKSh - Shkup u organizua tribunë shkencore me temën: Veshjet tradicionale në trevat shqiptare, në të cilën morën pjesë hulumtues shkencorë nga sfera e etnologjisë dhe folklorit.

c) Anëtar i redaksisë së përmbledhjeve të punimeve nga tribunat shkencore dhe i revistave shkencore:

Ka qenë kryeredaktor i redaksisë së revistës shkencore "Skupi", në të cilën publikohen punimet shkencore që prezantohen në konferencat, tribunat, seminarët dhe simpoziumet shkencore, që organizohen nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup. Kontributi i tij është i rëndësishëm në botimet e kësaj reviste, në të cilën publikohen punime nga tubimet shkencore, në të cilat ka qenë bartës kryesor përkatësisht koordinator.

Është anëtar i redaksisë së revistës ndërkombëtare shkencore "Studime Albanologjike". Revistën e boton Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup.

d) Pasqyra e konferencave, seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta në vend dhe jashtë:

Konferenca shkencore:

Në vitet 2019 dhe 2020, Sefer Tahiri ka qenë koordinator i konferencës shkencore "Ballkanologjia".

Në vitin 2019, është organizuar konferenca ndërkombëtare shkencore me temë "Figura e tjetrit në kulturën ballkanike". Në cilësinë e drejtuesit të projektit ka qenë edhe kryeredaktor i përmbledhjes së punimeve nga konferenca shkencore, ndërsa ka botuar edhe punimin autorial shkencor.

Në vitin 2020, është organizuar konferenca ndërkombëtare shkencore me temë "Ballkani midis së kaluarës, realitetit dhe perspektivës". Në cilësinë e drejtuesit të projektit ka qenë edhe kryeredaktor i përmbledhjes së punimeve nga konferenca shkencore, ndërsa ka botuar edhe punimin autorial shkencor.

Ka qenë pjesëmarrës me referat shkencor në konferencën shkencore "Seminari i Albanologjisë", i organizuar në Universitetin e Tetovës. Në konferencë ka prezantuar punimin "Shërbimi radiodifuziv publik i Maqedonisë së Veriut midis interesit partiak - politik dhe atij publik".

e) Aktivitete recensuese dhe promovuese:

Recensione:

Kandidati për thirrjen shkencore këshilltar shkencor në ITShKSh, Sefer Tahiri ka qenë recensues i përmbledhjes me titull "Gazetaria profesionale dhe e përgjegjshme", e botuar nga Metamorfozis: Fondacioni për Shoqëri dhe Internet në vitin 2017.

Ka qenë recensues i veprës shkencore të autorit Zeqirija Ibrahimimi me titull "Planifikimi gjuhësor në Maqedoni dhe studime tjera", i botuar nga ITShKSh në vitin 2019.

Tahiri ka qenë recensues i veprës shkencore të autorit Isamet Bakiu me titull "Ndarja e pushtetit si instrument i paqes në Ballkan", i botuar nga ITShKSh në vitin 2020.

Gjithashtu ka qenë edhe recensues i monografisë së autorit Ekrem Ebibi me titull "Fshati Radushë - qytezë nën hijen e historisë, gjurmë të një monografie", botuar nga Shoqata kulturore - humanitare "Radusha". Kjo monografi është botuar në vitin 2020.

Aktivitete promovuese:

Koordinator i projektit promovues "Instituti dhuron libra", në kuadër të së cilit ITShKSh dhuron vepra shkencore dhe publikime për shkollat dhe subjekte tjera shoqërore.

Ka qenë anëtar i këshillit organizues të manifestimit kulturor - shkencor "Ditët e alfabetit shqip" në vitin 2019 dhe 2020.

f) Përkthime:

Tahiri ka përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe përmbledhjen me dokumente me titull "Legjislacioni bazik antisemit i Mbretërisë së Bullgarisë", me hartues: Skender Asani, Nora Maliqi Zylali dhe Vllado Popovski, i bouar nga ITShKSh në vitin 2020.

3. Veprimtaria arsimore:

Dr. Sefer Tahiri nga viti akademik 2016/ 2017 ka koordinuar aktivitetet për akreditimin e dy programeve studimore pranë Institutit: Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Kulturologji. Në programin studimor Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare i ligjëron lëndët: Komunikimi ndërkulturor dhe identiteti dhe Komunikimi ndërkombëtar.

Aktivisht është i përfshirë në mësimdhënie në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, programi studimor: Komunikimi Ndërkombëtar, më parë programi studimor Komunikim. Çdo vit akademik, në vazhdimësi nga viti 2011 deri më sot është i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në lëndët: "Studimet e medias" dhe "Të shkruarit dhe raportimi mediatik". Çdo semestër ligjëron nga 6 orë (nga tre orë në dy lëndë në UEJL- Tetovë dhe UEJL- Shkup). Paralelisht ka qenë i angazhuar si mësimdhënës i lëndëve të njëjta për studentët me korrespondencë. Sipas evaluimit të studentëve është vlerësuar me nota maksimale, para së gjithash për shkak të qasjes që ka në mësimdhënie, duke i kombinuar njohuritë teorike dhe përvojën praktike. Kjo cilësi, por edhe përkushtimi në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në procesin e mësimdhënies është vlerësuar edhe nga menaxhmenti i fakultetit dhe universitetit, për çka dëshmi është angazhimi i vazhdueshëm nga viti 2008 si asistent, ndërsa nga viti 2011 si mësimdhënës dhe aktualisht në vitin 2021.

Në vitin 2019 ka qenë mentor për mbrojtjen e punimit të magistraturës së kandidatit Dejen Azeski me titull "Specifikat e rastit maqedonas për suksesin e dobët të transformimit të mediave tradicionale të shkruara në ato digjitale", i mbrojtur në vitin 2019 në Institutin e Studimeve të Komunikimit.

Ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen për mbrojtjen e punimit të magjistraturës së kandidatit Vlatko Mitkovski me titull "Format dhe mënyrat e zgjidhjes së krizës evropiane migrative", i mbrojtur në vitin 2018 në Institutin e Studimeve të Komunikimit.

Ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të Daniell Kallajxhiski me titull "Shkalla e profesionalizmit tek faqet e internetit në Maqedoni gjatë publikimit të informacioneve për shëndetin seksual dhe reprodutiv", i mbrojtur në vitin 2018 në Institutin e Studimeve të Komunikimit.

Ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatës Atixhe Selman me temë "Komunikimi i brendshëm organizativ efektiv në Televizionin Maqedonas - imperativ për krijimin e programit cilësor (produksioni) në gjuhët e bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i mbrojtur në vitin 2019 në Institutin e Studimeve të Komunikimit.

Ka qenë mentor i kandidatit Arbër Shaqiri, i cili në vitin 2020 në ITShKSh ku ka mbrojtur punimin e magjistraturës me titull "Ndikimi i lajmeve të rreme në proceset zgjedhore në skenën ndërkombëtare dhe ballkanike".

Ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës me titull "Mbrojtja e të drejtave të njeriut sipas konventave ndërkombëtare", i mbrojtur nga kandidati Lulzim Kashtanjeva në ITShKSh në vitin 2020.

Tahiri ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës me titull "Interpoli dhe Maqedonia e Veriut, historia dhe bashkëpunimi", i mbrojtur nga kandidati Azem Idrizi në ITShKSh në vitin 2019.

Ka qenë anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës "Migrimi - dikur dhe sot, me fokus Maqedoninë dhe Shqipërinë", i mbrojtur nga kandidati Benjat Emini në ITShKSh në vitin 2020.

Përveç që ka qenë anëtar i komisioneve për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimeve të magjistraturës, Tahiri ka qenë edhe anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatit Ermal Mehmeti në thirrjen bashkëpunëtor shkencor në ITShKSh në vitin 2020.

Ka qenë edhe anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatës Nora Maliqi Zylali në thirrjen bashkëpunëtoreshkencore në ITShKSh në vitin 2020.

Ka qenë edhe anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatës Lindita Ahmeti në thirrjen asistente - hulumtuese në ITShKSh në vitin 2021.

4. Veprimtaria profesionale - aplikative dhe veprimtaria me interes më të gjerë:

Dr. Sefer Tahiri është anëtar i Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup. Poashtu është edhe redaktor i Buletinit të ITShKSh -së. Ai është i angazhuar në aktivitete të interesit publik dhe shoqëror, duke u angazhuar me mendimet dhe analizat e tij ekspertuese para së gjithash për lirinë e medias dhe shprehjes, për respektimin e standardeve profesionale dhe normave etike në

media dhe për reforma në sistemin mediatik në Maqedoni. Në këtë funksion dr. Tahiri merr pjesë në shumë projekte që kanë në fokus mediat dhe komunikimin. Nga viti 2014 është anëtar i Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës së Mediave në Maqedoni, ndërsa deri në vitin 2018 ishte edhe anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Maqedonas të Medias. Ka qenë anëtar i komisioneve për ndarjen e çmimeve në nivel të qytetit të Shkupit, por edhe anëtar i komisionit të çmimit ndërkombëtar gazetaresk, i dhënë nga Bashkimi Evropian për gazetari hulumtuese në Kosovë në vitin 2020. Gjithashtu me analizat e tij merr aktivisht pjesë në debatet publike rreth fenomeneve politike dhe shoqërore, ndërsa rregullisht një herë në muaj publikon analiza dhe mendime në revistën mujore “Shenja”.

5) Vlerësim dhe propozim:

Nga analiza e punimeve shkencore dhe veprimtarisë hulumtuese shkencore, veprimtarisë arsimore dhe veprimtarisë së rëndësishme shoqërore dhe eksperte-publike të dr. Sefer Tahirit erdhëm deri te e dhëna se si metodologjikisht, por edhe përmbajtësisht, ky autor në qendër të interesit të tij shkencor i ka aspektet kulturologjike, komunikatave dhe politike të komunikimit ndërkulturor në vend, me theks të posaçëm raportin midis medieve dhe krijimit të politikave për raportet ndërkulturore, si dhe krijimin e shoqërisë harmonike e funksionale multikulturore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në hulumtimet e tij Dr. Tahiri ka përfshirë njohuritë më bashkëkohore teorike me qëllim që këto hulumtime të shërbejnë si platformë për krijimin e politikave për përmirësimin e edukimit mediatik në arsim, për krijimin e politikës përkatëse mediatike për promovimin e suksesshëm të komunikimit ndërkulturor dhe ngritjen e vetëdijes për nevojën e tolerancës e mirëkuptimit midis popullatës në Maqedoni dhe më gjerë në rajonin ballkanik. Punimet e dr. Tahirit janë të karakterit interdisciplinar dhe në to gërshetohen më shumë fusha shkencore: Komunikimi dhe mediat, Etnografia e mediave dhe Sociologjia e kulturës.

Duke njohur opusin shkencor dhe aktivitetet mësimdhënëse të Dr. Tahirit, mund të konkludojmë se ai ka arritur rezultate të rëndësishme shkencore që kanë ndikim në zhvillimin e shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ka marrë pjesë në projekte dhe debate të rëndësishme shoqërore si dhe në projekte për aftësimin e kuadrove të rinj hulumtues shkencor.

Duke pasur parasysh gjithë këtë, kemi kënaqësinë e veçantë, t'i propozojmë Këshillit Shkencor të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve- Shkup, dr. Sefer Tahiri të zgjidhet në thirrjen KËSHILLTAR SHKENCOR / PROFESOR ORDINAR, që e meriton plotësisht sipas të gjitha kualifikimeve dhe rezultateve të tij shkencore, të arritura në veprimtarinë hulumtuese-shkencore, veprimtarinë arsimore, veprimtarinë publicistike dhe profesionale- shoqërore.

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Qemal Murati, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Liljana Siljanovska, anëtare, d.v.
3. Prof. dr. Izaim Murtezani, anëtar, d.v.

Aneks

FORMULAR
I REFERATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE

Kandidati: **Dr. Sefer Tahiri**

Institucioni: IPSH Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

Departamenti: Lidhjet e Ndërsjella Kulturore, Historike dhe Gjuhësore midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe Popujve tjerë të Rajonit

Tabela 1

Nr ren	VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE	Pikët	
		Vendore/ Ndërkomb.	
1.	<i>-Monografi:</i>		
	Rruga e kampionit olimpik Shaban Tërstena (koautor), botues: Shaban Tërstena, Shkup, 2017	6	
	Trajtesa identitare (autor), ITShKSh, Shkup, 2018	8	
	Raportimi në interes të publikut - mbrojtja e parimeve etike në raportim përmes punës së Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media (koautor i publikimit), Këshilli i Etikës në Media, Shkup, 2017 Link: https://www.semm.mk/dokumenti/publikacii/271-izvestuvanje-vo-interes-na-javnosta	7	
2.	<i>-Pjesë e monografisë:</i>		
	Maqedonia nga Bukureshti deri te Prespa -dëshmi të një kohe: Maqedonia 2008-2018, Fondacioni Shoqëri e Hapur, Shkup, 2020 Link: https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/02/foom-od-bukurest-do-prespa-mk-za-web.pdf	4	
	Midis shoqërisë së ndarë dhe një shoqëri (reflektime maqedonase), Avant pres, Shkup, 2021	4	
3.	<i>-Punim me rezultate origjinale shkencore, i publikuar në revistë shkencore/ profesionale:</i>		
	Roli i mediave në përhapjen e stereotipave fetare dhe islamofobisë në Republikën e Maqedonisë, revista shkencore "Centrum", numër 8, Qendra për Bashkëpunim dhe Mirëkuptim Institucional, Shkup, 2017 Link: http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/12/PJESA-19.pdf	4	
4.	<i>-Punim me rezultate origjinale shkencore, i publikuar në revistë shkencore me redaksi ndërkombëtare:</i>		
	Statusi juridik - kushtetues i shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, "Studime albanologjike", numër 20, ITShKSh, Shkup, 2020 Link: https://www.itsh.edu.mk/studime-albanologjike-shkarko/	6	

5.	<i>-Punim me rezultate origjinale shkencore, i publikuar në përmbledhje nga tubimi shkencor ndërkombëtar</i>		
	Mediat dhe komunikimi ndërkulturor në Ballkan, "Ballkanologjia 1", ITSHKSH, Shkup, 2019	3	
	Shqiptarët dhe maqedonasit në diskursin mediatik dhe politik në Maqedoninë e Veriut nga periudha e pluralizmit deri më sot, "Ballkanologjia 2", ITShKSh, Shkup, 2020	3	
6.	<i>-Abstrakt i publikuar në përmbledhje nga konferenca shkencore:</i>		
	Abstrakt i publikuar në përmbledhjen "Ballkanologjia 1", ITShKSh, Shkup, 2019	0,5	
7.	<i>-Pjesëmarrje në tubim shkencor nacional me referat:</i>		
	"Seminari i Albanologjisë", e organizuar në Universitetin e Tetovës. Ka prezantuar punimin "Shërbimi radiodifuziv publik i Maqedonisë së Veriut midis interesit partiak - politik dhe atij publik" (viti 2020).	1	
8.	<i>-Pjesëmarrje në tubim shkencor ndërkombëtar me referat:</i>		
	Pjesëmarrës me punim shkencor në konferencën ndërkombëtare shkencore me temë "Figura e tjetrit në kulturën ballkanike". (viti 2019).		2
	Pjesëmarrës me punim shkencor në konferencën ndërkombëtare shkencore me temë "Ballkani midis së kaluarës, realitetit dhe perspektivës". (viti 2020).		2
		46,5	4
	<i>Gjithsej</i>		50.5
	<i>Veprimtaria arsimore</i>		
	<i>-Mentor i punimit të magjistraturës:</i>		
	Mentor për mbrojtjen e punimit të magjistraturës së kandidatit Dejan Azeski me titull "Specifikat e rastit maqedonas për suksesin e dobët të transformimit të mediave tradicionale të shkruara në digjitale", i mbrojtur në vitin 2019 në Institutin e Studimeve të Komunikimit.	2	
	Mentor i kandidatit Arbër Shaqiri, i cili në vitin 2020 në ITShKSh ka mbrojtur punimin e magjistraturës me titull "Ndikimi i lajmeve të rreme në proceset zgjedhore në skenën ndërkombëtare dhe ballkanike".	2	
	<i>-Anëtar i komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës:</i>		
	<ul style="list-style-type: none"> •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatit Vllako Mitkovski. •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatit Daniell Kallajxhiski. •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatit Atixhe Selman. •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatit Lulzim Kashtanjeva. •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të kandidatit Amir Idrizi. •Anëtar i Komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të 	6x0.5 =3	

	magjistraturës të kandidatit Benjat Emini.		
	<i>-Mësim/ ligjërata në institucionet e arsimit sipëror të ciklit të parë dhe të dytë:</i>		
	Studimet e medias, semestri veror, viti akademik 2016/2017, 2017/2018, 2018/2019, 2019/2020/2020/2021, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë	225x0 .04 =9	
	Të shkruarit dhe raportimi mediatik, semestri dimëror, viti akademik 2016/2017, 2017/2018, 2018/2019, 2019/2020/2020/2021, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë	225x0 .04 =9	
	Gjithsej		25

Tabela 3

Nr. ren	VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE DHE VEPRIMTARIA E INTERESIT TË GJERË	Pikët	
1.	<i>-Kryeredaktor i revistës shkencore/ përmbledhjes me punime shkencore:</i>		
	Kryeredaktor i revistës shkencore "Skupi 15"	2	
	Kryeredaktor i revistës shkencore "Skupi 18"	2	
	Kryeredaktor i revistës shkencore "Skupi 21"	2	
	Kryeredaktor i revistës shkencore "Skupi 26"	2	
	Kryeredaktor i revistës shkencore "Skupi 29"	2	
	Kryeredaktor i përmbledhjes me punime "Ballkanologjia 2"		4
	Kryeredaktor i përmbledhjes me punime "Ballkanologjia 3"		4
2.	<i>-Kryetar i Këshillit organizues të tubimit shkencor:</i>		
	Kryetar i Këshillit organizues të konferencës ndërkombëtare shkencore me temë "Figura e tjetrit në kulturën ballkanike. (viti 2019).		4
	Kryetar i Këshillit organizues të konferencës ndërkombëtare shkencore me temë "Ballkani midis së kaluarës, realitetit dhe perspektivës" (viti 2020).		4
3.	<i>-Promotor i monografisë/ përmbledhjes me dokumente:</i>		
	Promotor i monografisë " me titull "Fshati Radushë - qytezë nën hijen e historisë, gjurmë të një monografie", 16.07.2020, ITShKSh	0.5	
	Promotor i përmbledhjes me dokumente me titull "Legjislacioni bazik antisemit i Mbretërisë së Bullgarisë". Hartues: Skender Asani, Nora Maliqi Zylali dhe Vllado Popovski, 10.03.2021, AShAM	0.5	
4.	<i>-Moderator dhe drejtues i sesionit të konferencës/ tribunës shkencore:</i>		
	Moderator i konferencës ndërkombëtare shkencore me temë "Figura e tjetrit në kulturën ballkanike", 26.10. 2019, ITShKSh	0.5	
	Moderator i konferencës ndërkombëtare shkencore me temë "Ballkani midis së kaluarës, realitetit dhe perspektivës", 25.10.2020. Shkup	0.5	
5.	<i>-Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të Institutit:</i>		

	Koordinator i projektit promovues të ITShKSh-së "Instituti dhuron libra" (viti 2020)	1	
6.	<i>-Pjesëmarrje në punën e komisioneve dhe garave shtetërore:</i>		
	Anëtar i Komisionit për publicistike për ndarjen e çmimit të Qytetit të Shkupit "13 nëntori", viti 2016	0.5	
7.	<i>-Anëtar i Këshillit të Institutit:</i>		
	Anëtar i Këshillit të Institutit nga viti 2016	2	
8.	<i>-Sekretar shkencor i Institutit:</i>		
	Sekretar shkencor i Institutit nga viti 2018	4	
9.	<i>-Udhëheqës i Departamentit (njësisë së brendshme organizative):</i>		
	Udhëheqës i Departamentin e Lidhjeve të Ndërsjella Kulturore, Historike dhe Gjuhësore midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve dhe Popujve tjerë të Rajonit pranë ITShKSh-së (vitet 2015-2018).	3	
10.	<i>-Anëtar i komisioneve pranë Institutit (aktivitetet eksperte dhe të tjera):</i>		
	Anëtar i Komisionit për Furnizime Publike pranë ITShKSh-së nga viti 2016	0.5	
11.	<i>-Redaktor i buletinit të ITShKSh-së</i>	0.5	
12.	<i>-Anëtar i komisioneve dhe trupave të organeve shtetërore/ shoqatave:</i>		
	Kryetar i Sindikatës së ISHP ITShKSh - Shkup nga viti 2020	1	
	Anëtar i Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media në Maqedoninë e Veriut nga viti 2014	1	
13.	<i>-Anëtar i komisionit për zgjedhje në thirrje:</i>		
	Anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatit Ermal Mehmeti në thirrjen asistent - hulumtues në ITShKSh në vitin 2020.	0.5	
	Anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatës Lindita Ahmeti në thirrjen asistente - hulumtuese në ITShKSh në vitin 2021.	0.5	
	Anëtar i Komisionit për zgjedhjen e kandidatës Nora Maliqi Zylali në thirrjen bashkëpunëtore shkencore në ITShKSh në vitin 2020.	0.5	
14.	<i>-Recensent i monografisë/ përmbledhjeve me punime shkencore:</i>		
	Recensues i përmbledhjes me titull "Gazetaria profesionale dhe e përgjegjshme", e botuar nga Metamorfozis: Fondacioni për shoqëri dhe internet në vitin 2017. Link: http://proverkanafakti.mk/wp-content/uploads/2017/07/Profesionalno-i-odgovorno-novinarstvo-WEB.pdf	1	
	Recensues i veprës shkencore të autorit Zeqirija Ibrahimimi me titull "Planifikimi gjuhësor në Maqedoni dhe studime tjera", ITShKSh, Shkup, në vitin 2019	1	
	Recensues i veprës shkencore të autorit Isamet Bakiu me titull "Ndarja e pushtetit si instrument i paqes në Ballkan", i botuar nga ITShKSh në vitin 2020.	1	
	Recensues i monografisë së autorit Ekrem Ebibi me titull "Fshati Radushë - qytezë nën hijen e historisë, gjurmë të një monografie", botuar nga Shoqata kulturore - humanitare "Radusha". Kjo monografi është botuar në vitin 2020.	1	
	Gjithsej	31	16

		47
REFERENCAT KUMULATIVE PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE TË KANDIDATIT DR. SEFER TAHIRI:		Pikët
VEPRIMTARIA HULUMTUESE - SHKENCORE		50.05
VEPRIMTARIA ARSIMORE		25
VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE		47
Gjithsejtë		122.5

Shkup, 4. 5. 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Qemal Murati, kryetar, d.v.
2. Prof. dr. Liljana Siljanovska, anëtare, d.v.
3. Prof. dr. Izaim Murtezani, anëtar, d.v.